



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 388 Akti

Nr. 496 Vendimi
Tiranë, më 12.1.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 10.1.2021, në orën 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Ermira Dedja**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, komisionere Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Ermira Dedja, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Ermira Dedja është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
2. Znj. Ermira Dedja, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 16.12.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Etleda Çiftja.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; si dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin, datë 13.1.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Pamela Qirko, të gjithë anëtarët të deklarojnë mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe të fillojë hetimi administrativ i thellë dhe i gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.
5. Në datën 13.1.2020, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit, mbi përbërjen e trupit gjykues dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni i kërkoi, gjithashtu, subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.
6. Trupi gjykues, me vendimin e datës 3.12.2020, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Ermira Dedja, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016, të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat

¹E-mail, datë 13.1.2020, ora 16:46, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

7. Në datën 3.12.2021, përmes postës elektronike², trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim, subjektit iu kërkuua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 5.7.2021.

8. Në datën 23.12.2021, përmes postës elektronike³, subjekti paraqiti pretendimet me shkrim dhe dokumentacionin justifikues bashkëlidhur pretendimeve në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

9. Më tej, Komisioni, me anë të postës elektronike⁴, njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues, me vendimin e datës 6.1.2022, vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 10.1.2022, në orën 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

10. Me kërkesën e datës 6.1.2022, të paraqitur përmes postës elektronike⁵, subjekti kërkoi ndryshimin e orarit të seancës dëgjimore të paracaktuar me arsyetimin se përfaqësuesja e saj ligjore në të njëjtën datë dhe orë ishte në një seancë tjetër pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

11. Komisioni, me vendimin e datës 7.1.2022, vendosi pranimin e kërkesës së subjektit për ndryshimin e orarit dhe me anë të postës elektronike⁶ njoftoi subjektin për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 10.1.2022, ora 14:00.

12. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ermira Dedja, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Në datën 10.1.2022 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

²E-mail, datë 3.12.2021, ora 14:20, “Komisioni – njoftim mbi përfundimin e hetimit administrativ kryesisht mbi procesin tuaj të rivlerësimit”.

³E-mail, datë 3.12.2021, ora 20:03, “Re: Komisioni – njoftim mbi përfundimin e hetimit administrativ kryesisht mbi procesin tuaj të rivlerësimit”.

⁴E-mail, datë 6.1.2022, ora 10:29, “Komisioni – ftesë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore publike”.

⁵E-mail, datë 6.1.2022, ora 1:17, “Re: Komisioni – ftesë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore publike”.

⁶E-mail, datë 7.1.2022, ora 22:14.

14. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë bashkë me përfaqësuesen ligjore avokate R.Z.

15. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

16. Znj. Ermira Dedja, pasi dëgjoi relacionin, bashkë me përfaqësuesen ligjore, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

17. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin Ermira Dedja, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

18. Seanca dëgjimore e datës 10.1.2022 u ndërpre, për të rifilluar në datën 12.1.2022, për shpalljen e vendimit.

19. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 10.1.2022, subjekti i rivlerësimit Ermira Dedja, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Subjekti i rivlerësimit Ermira Dedja, ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

22. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; dhe (iii) KLGJ-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

23. Referuar vendimit nr. 2/2017⁷ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli

⁷Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”.

dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

24. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Ermira Dedja, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

25. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private për periudhën 2003 – 2016 dhe në datën 28.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje pasurie;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të vitit 2017”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI, për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; si dhe (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

27. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve

Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “*Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë*”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “*Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse*”.

të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

28. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur, apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si vijon: (1) A.D., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, i cili ka ndërruar jetë në datën 26.3.2012 – konsiderohet person i lidhur; (2) G.D., i biri i subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur; (3) R.D., i biri i subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur; (4) A.D. (V.), e motra e bashkëshortit të subjektit dhe L.D., nëna e bashkëshortit të subjektit – konsiderohen persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, për shkak të dhurimit të bërë në favor të bashkëshortit të subjektit A.D., duke i dhuruar pjesën e tyre të pandarë, të fituar me anë të trashëgimisë, në pasurinë shtëpi banimi me sip. 85.29 m² ndërtesë, 13.1 m² verandë dhe 375 m² truall, me vendndodhje në Shkodër.

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Shtëpi banimi me sip. 85.29 m² ndërtesë, 13.1 m² verandë dhe truall me sip. 375 m², si dhe truall me sip. 80 m²

1.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtëpi banimi me sip. 85.29 m², verandë me sip. 13.1 m² bashkë me shkallët funksionale, truall me sip. 375 m², si dhe truall me sip. 80 m² e regjistruar në emër bashkëshortit të ndjerë të subjektit, A.D., me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Shkodër, me 1/3 pjesë takuese. Si burim krijimi deklaroi zgjidhjen e bashkëpronësisë, me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 4.7.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, mes bashkëshortit dhe bashkëpronareve të tjerë Dedja dhe vendimin gjyqësor nr. ***, datë 19.11.2012, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin A.D., që ka përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë bashkëshorten Ermira Dedja dhe dy fëmijët G. dhe R.D., të cilët trashëgojnë në pjesë të barabarta nga 1/3 pjesë takuese. Për vërtetimin e deklaramit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁸.

⁸Certifikatë trashëgimie nr. ***, datë 26.4.1956; kontratë, datë 21.3.1956; shkresë, datë. 25.5.1956, drejtuar Bankës së Shtetit Shqiptar për dhënie kredie ndërtimi shtetasit O.D.; vërtetim; urdhër shërbimi; preventiv; vërtetim, datë 28.5.1956; shkresë nr. *** prot., datë 13.7.1956; prokurë e posaçme nr. ***, datë. 25.3.1956; vërtetim nënshkrimi nr. ***, datë 26.3.1957; raport kontrolli; vërtetim nr. ***, datë 20.10.1955; vendim nr. ***, datë 23.7.2004, nga ZVRPP-ja Shkodër; kërkesë për regjistrim prone “Dedja”; deklaratë personale Tr. Dedja; deklaratë e pronarëve kufitarë; plan rievimi; planimetria e vitit 1962-1981; shkresë, datë 17.7.1962; notë inskriptimi nr. ***, datë 31.12.1957; deklaratë, datë. 14.4.1956; vendim nr. ***, datë 16.4.2004, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për çeljen e trashëgimisë pas vdekjes së shtetasve A.D., N.D. dhe O. D.; vërtetim pronësie, datë15.6.1995; akt heqje dorë pasuri e paluajtshme nr. ***, datë 13.3.2007; kartelë e pasurisë së paluajtshme nr. ***, z. k. ***; vërtetim nga dokument hipotekor nr. ***, datë 28.7.2004, bashkë me listë e bashkëpronareve dhe hartën treguese; (25) Kontratë akt dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.3.2007; kartelë e pasurisë së paluajtshme; vendim nr. ***, datë 22.9.2006, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për çeljen e trashëgimisë pas vdekjes së M.K.; vendim nr. regj. them. ***, datë 21.3.2007, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër; vendim nr. ***, datë 4.7.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

1.2. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja Shkodër⁹, rezulton se në regjistrin e pasurive të paluajtshme është regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Ermira Dedja, G.D. dhe R.D., pasuria nr. ***, z. k. ***, e llojit “truall”, me sipërfaqe totale 375 m², nga të cilat 48 m² ndërtesë, me 1/3 pjesë secili prej tyre, me vendndodhje në rrugën “****”, Shkodër. Gjithashtu, rezulton se në bashkëpronësi të shtetasve B.D., R.D., A.D., I.D., Ermira Dedja, G.D., dhe R.D., figuron e regjistruar pasuria me nr. ***, Zk. ***, e llojit “truall”, me sip. 80 m², me vendndodhje në rrugën “****”, Shkodër, në të cilën Ermira Dedja, G.D. dhe R.D. janë bashkëpronarë në 1/15 pjesë/secili. Regjistrimi i këtyre pasurive në emër të shtetasve Ermira Dedja, R.D. dhe G.D. është bërë në bazë të dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 2.11.2017, të ndjerit A.D.

1.3. Sipas dokumenteve të origjinës së pronës që disponon ASHK-ja Shkodër¹⁰ rezulton se në emër të bashkëpronarëve Dedja është regjistruar pasuria nr. ***, z. k. ***, e llojit “truall”, me sipërfaqe totale 1230 m², nga të cilat 132 m² ndërtesë, në rrugën “****”, Shkodër. Në këtë pasuri, i ndjeri A.D. ishte bashkëpronar në 1/12 pjesë. Regjistrimi i kësaj pasurie në emër të bashkëpronarëve Dedja është bërë në zbatim të vendimit nr. ***, datë 23.7.2004, të ZVRPP-së Shkodër, “Për regjistrimin e pasurive në bazë të nenit 24/b” dhe të dokumentacion shoqërues.

1.4. Sipas dokumentit “Akt heqje dorë pasuri e paluajtshme truall + shtëpi banimi”, nr. ***, datë 13.3.2007, të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 (të administruar edhe nga notere A.A.¹¹), shtetasit Xh.B., F.B., H.B., O.Z., R.B., dhe A.B., kanë hequr dorë nga pjesa takuese në pasurinë nr. ***, z. k. ***, e llojit “truall”, me sipërfaqe totale 1230 m², nga të cilat 132 m² ndërtesë, në rrugën “****”, Shkodër, duke ia kaluar pjesën e tyre të gjithë bashkëpronarëve të tjerë. Pas heqjes dorë së këtyre shtetasve ndryshoi pjesa takuese e bashkëpronarëve të tjerë, nga të cilët shtetasit L.A.D., A.O.D. dhe A.O.D. u bënë bashkëpronarë në pasurinë e mësipërme në 1/9 pjesë secili.

1.5. Me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 19.3.2007, shtetasit L.D. dhe A.D.-V. i kanë dhuruar shtetasit A.D. pjesën e tyre takuese (të pandarë) në pasurinë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe truall 1230 m², nga të cilat 132 m² ndërtesë, e ndodhur në lagjen “****”, Shkodër. Pas nënshkrimit të kësaj kontrate shtetasi A.D. u bë bashkëpronar me 1/3 pjesë në pasurinë e mësipërme.

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 25.2.2020; kartelë e pasurisë nr. ***, z. k. ***, kartelë e pasurisë nr. ***, z. k. ***, dëshmi trashëgimie ligjore nr. ***, datë 2.11.2017.

¹⁰Kërkesë për regjistrim pronësie; deklaratë personale e datës 13.7.2004, e shtetasit A.D.; deklaratë noteriale e pronarëve kufitar, datës 13.7.2004; plan rievimi; planimetria e vitit 1962-1981; urdhër shërbimi; raport-kontrolli, datë 20.11.1957; vërtetim, datë 20.10.1957; autentifikim nënshkrimi nr. ***, datë 26.3.1957; prokurë e posaçme nr. ***, datë 25.3.1957; shkresë nr. ***, datë 13.7.1956, e Komitetit Ekzekutiv K. P. Shkodër; vërtetim datë 9.6.56; vërtetim i Komitetit Ekzekutiv, datë 28.5.56; shkresë e datës 25.5.1956 e shtetasit O.D.; kontratë e datës 21.3.1956; certifikatë trashëgimie nr. ***, datë 26.4.1956; deklaratë e datës 14.4.1957 e shtetasit O.D.; notë inskriptimi nr. ***, datë 31.12.1957; vërtetim pronësie e Zyrës së Hipotekës Shkodër, datë 15.6.1995; shkresë, datë 17.7.1962, e Bankës së Shtetit Shqiptar; vendim nr. ***, datë 16.4.2004, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për lëshimin e trashëgimisë së shtetasve A.D. dhe N.D.; vërtetim hipotekor; kartelë e pasurisë nr. ***, z. k. ***, në pronësi të shtetasit A.D.; urdhër nr. *** prot., datë 21.3.2008, nga ZVRPP-ja Shkodër; plan rievimi, datë 11.3.2008; vendim nr. ***, datë 4.7.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; kontratë nr. ***, datë 19.3.2007.

¹¹Shkresë, datë 5.7.2021.

1.6. Me vendimin nr. ***, datë 4.7.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është vendosur zgjidhja e marrëdhënies së bashkëpronësisë ndërmjet paditësit A.O.D. me të paditurit A.D., I.D., R.D., B.D. mbi pasurinë e paluajtshme të regjistruar në ZVRPP-në Shkodër me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sipërfaqe trualli 1150 m² dhe sipërfaqe ndërtimore 132 m². Sipas këtij vendimi, në bashkëpronësi të ndërgjyqësve është lënë në bashkëpronësi një sipërfaqe trualli prej 80 m², ndërsa paditësi A.D. ka marrë në pronësi: në katin përdhes një dhomë, një pjesë kuzhine plus aneks me sipërfaqe ndërtimi 48 m², në katin e parë një dhomë, pjesë korridorit dhe banjë me sipërfaqe ndërtimi 37,29 m², gjithsej 85,29 m², verandë me sip. 13.1 m² dhe një sipërfaqe trualli prej 375 m².

1.7. Më pas, rezulton se bashkëshorti i subjektit ka ndërruar jetë më 26.3.2012 dhe me vendimin nr. ***, datë 19.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore për të ndjerin A.D., duke përcaktuar trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë: bashkëshorten Ermira Dedja dhe fëmijët G.D. dhe R.D., të cilët trashëgojnë në mënyrë të barabartë 1/3 pjesë të pasurisë trashëgimore.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.8. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

1.9. Nga hetimi administrativ u provua se bashkëpronësia e subjektit dhe fëmijëve G.D. dhe R.D., me 1/3 pjesë secili prej tyre, në pasurinë me nr. ***, z. k. ***, e llojit truall, me sipërfaqe totale 375 m² nga të cilat 48 m² ndërtesë, me adresë rruga “****”, Shkodër dhe në pasurinë me nr. ***, z.k. ***, e llojit truall, me sipërfaqe 80 m², me adresë rruga “****”, Shkodër, në 1/15 pjesë, rrjedh nga marrëdhënia e trashëgimisë së bashkëshortit të subjektit, i cili është bërë pronar i tyre me vendimin nr. ***, datë 4.7.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që ka vendosur zgjidhjen e marrëdhënies së bashkëpronësisë dhe caktimin fizikisht të pjesës së tij takuese në pasurinë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, nga e cila, pas pjesëtimit, rrjedh pasuria me nr. ***, z. k. ***, Shkodër.

1.10. Më pas, rezulton se bashkëshorti i subjektit ka ndërruar jetë në datën 26.3.2012 dhe me vendimin nr. ***, datë 19.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 dhe dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 2.11.2017, të administruar nga ASHK-ja, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore për të ndjerin A.D., duke përcaktuar trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë bashkëshorten Ermira Dedja dhe fëmijët G. dhe R.D., të cilët trashëgojnë në mënyrë të barabartë 1/3 pjesë të pasurisë trashëgimore.

1.11. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit me dokumentacionin e depozituar, konfirmuar dhe nga hetimit i Komisionit, provoi se shtetasit L.D. dhe A.D.-V., përkatësisht nëna dhe motra e bashkëshortit të subjektit, i kanë dhuruar bashkëshortit të subjektit (shtetasit A.D.) pjesën e

tyre takuese, të pandarë, që kanë trashëguar nga shtetasi O.D. (babai/bashkëshorti), pasurinë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***.

1.12. Në përfundim, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, burimin e ligjshëm të trashëgimisë për krijimin e kësaj pasurie.

2. Apartament me sip. 104 m², në vlerën 4.680.000 lekë, Shkodër

2.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë apartament banimi me sip. 104 m², blerë me kontratë sipërmarrjeje, datë 29.3.2010, në shumën 4.680.000 lekë, në bashkëpronësi fillimisht me bashkëshortin me pjesë 1/2 dhe pas vdekjes së tij, pjesa e bashkëshortit, sipas dëshmisë së trashëgimisë, është në bashkëpronësi me fëmijët G. dhe R.D., me 1/6 pjesë takuese me trashëgimi. Nuk ka deklaruar burim krijimi. Për vërtetimin e deklaramentit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹².

2.2. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* të vitit 2017¹³, rezulton se ndërmjet shtetasit M.M., në cilësinë e investitorit dhe shtetasit A.D. është lidhur kontrata e sipërmarrjes e datës 29.3.2010, ku nënshkrimet e palëve janë verifikuar nga noteri sipas dokumentit “autentifikim nënshkrimi”, nr. ***, datë 29.3.2010. Në kontratë pasqyrohet se: *“Investitori M.M. është pronar i pasurisë me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 310 m², e llojit ‘truall’, të ndodhur në lagjen ‘***’, Shkodër. Në këtë truall investitori do të ndërtojë një godinë *** kate + bodrum për të cilën është miratuar sheshi i ndërtimit nga KRRT-ja Bashkia Shkodër me vendim nr. 3, datë 4.4.2006 dhe leja e ndërtimit me vendimin nr. 7, datë 10.6.2006, të KRRT-së Shkodër. Punimet për ndërtimin e këtij objekti do të kryhen nga firma ndërtuese ‘***’ sh.p.k. Porositësi A.D. kërkon të porosisë apartament banimi me sip. rreth 104 m² (vetëm sipërfaqe e shfrytëzueshme). Apartamenti do të jetë në katin e ***-të, të banimit të ndërtuesës. Çmimi i apartamentit të porositur është 45.000 lekë/m² dhe nuk ndryshon pavarësisht nga lëvizjet e çmimeve, në total në vlerën 4.680.000 lekë. Porositësi ka likuiduar deri sot vlerën 4.180.000 lekë, nga të cilat 2.180.000 lekë janë likuiduar gjatë vitit 2009 dhe 2.000.000 lekë janë likuiduar sot. Kësti i fundit prej 500.000 do të likuidohet nga porositësi me firmosjen e kontratës së shitblerjes së apartamentit të banimit”.*

2.3. Komisioni, nëpërmjet sistemit elektronik të ASHK-së, verifikoi dokumentacionin e regjistrimit të objektit të ndërtuar në pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***¹⁴ dhe konstaton formularin nr. 2, “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij”, nr. *** prot., datë 4.4.2006, të KRRT-së së Bashkisë Shkodër, në emër të z. M.M., ku pasqyrohet se, me vendimin nr. 3, datë 4.4.2006, KRRT-ja miratoi sheshin e ndërtimit për objektin “godinë *** kat + bodrum (kati përdhes dyqane-bodrum-*** kat banim)”. Gjithashtu, rezulton se ndërmjet shtetasit M.M., në cilësinë e porositësit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 9.8.2006, me objekt

¹²Kontratë sipërmarrjeje, datë 29.3.2010; autentifikim nënshkrimi nr. ***, datë 29.3.2010; vendim nr. ***, datë 19.11.2011, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin A.D.

¹³Kontratë sipërmarrjeje, datë 29.3.2010; autentifikim nënshkrimi nr. ***, datë 29.3.2010.

¹⁴Formulari n. 2 “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij”, nr. *** prot., datë 4.4.2006, i KRRT-së së Bashkisë Shkodër; formulari 4, “Leje ndërtimi”, nr. *** prot., datë 13.10.2006, i KRRT-së së Bashkisë Shkodër; 4 fletë projekti; certifikata e pronësisë e pasurisë nr. ***, z. k. ***,kontratë e sipërmarrjeje nr. ***, datë 9.8.2006; leje e shfrytëzimit nr. *** prot., datë 25.8.2009, e Bashkisë Shkodër; aktkolaudimi tekniko-ekonomik, pa datë.

“ndërtim pallati gjashtë katësh + bodrum”, lagjja “****”, rruga “****”, Shkodër, ku palët kanë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet për secilën palë sipas parashikimeve të neneve 850-875, të Kodit Civil, që rregullojnë kontratën e sipërmarrjes.

2.4. Më pas, konstatohet formulari 4, “leje ndërtimi”, nr. *** prot., datë 13.10.2006, i KRRT-së së Bashkisë Shkodër, ku pasqyrohet se me vendimin nr. 7, datë 10.6.2006, të Këshillit Teknik, është miratuar leja e ndërtimit për shtetasin M.M., për objektin “godinë *** kat+bodrum (kati përdhes dyqane-bodrum-**** kat banim)”, me subjekt ndërtues “****” sh.p.k. Pjesë e dosjes së regjistrimit janë dhe 4 fletë të projektit teknik, ku në vulën teknike të secilës prej tyre pasqyrohet shënimi *porositës M.M. dhe arkitekt A.D.*, si dhe leja e shfrytëzimit nr. *** prot., datë 25.8.2009, e Bashkisë Shkodër dhe akti i kolaudimit tekniko-ekonomik pa datë.

2.5. Komisioni hetoi lidhur me çmimin mesatar të shitjes së apartamenteve në tregun e lirë në qytetin e Shkodrës, ku në kushtet e mungesës së informacionit për vitin 2009, verifikoi këtë çmim për vitin 2010¹⁵, ku parashikohej në vlerën 51.405 lekë/m². Pra, çmimi i referencës për këtë apartament rezulton të jetë më i lartë se çmimi i blerjes sipas kontratës.

2.6. Në përgjigje të pyetësorit standard¹⁶, lidhur me adresat ku ka banuar nga momenti që ka marrë detyrën, subjekti deklaroi se kur ka marrë detyrën për herë të parë ka jetuar në vendndodhje lagjja “****”, rruga “****”, pallati nr. **, Shkodër, banesë shtetërore pajisur me autorizim të dhënë shtetasit H.K., babai i subjektit. Nga korriku i vitit 1996, kur ka lidhur martesën ligjore me bashkëshortin A.D., ka jetuar në shtëpinë e prindërve të tij, me adresë lagjja “****”, rruga “****”, nr. **, Shkodër. Prej marsit të vitit 2009 ka banuar në rrugën “****” ose “****”, ku vazhdon të banojë edhe sot.

2.7. Për të vërtetuar deklarin e subjekti mbi adresat e banimit, Komisioni administroi informacion nga FSHU-ja¹⁷, nga ku rezultoi se shtetasi A.D. ka lidhur kontratën e furnizimit me energji elektrike në datën 31.10.2008, në rrugën “****”, pallati nr. **. Në kushtet kur kontrata e energjisë elektrike ishte lidhur përpara kontratës së porosisë, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁸, i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me mospërputhjen e deklarin për kohën kur ka filluar të banojë në apartamentin në adresën rruga “****”. Në përgjigje¹⁹, subjekti sqaron se banesa e mëparshme ku ka jetuar, me vendndodhje në lagjen “****”, Shkodër, për shkak të amortizimit të saj nga viti në vit ishte bërë e pabanueshme dhe në kushtet kur kishte dy fëmijë dhe djali i vogël R.D. shfaqti problematika shëndetësore që lidheshin me kushtet e asaj shtëpie (lagështira, myku, demolimi) e kishte të nevojshme për të lëvizur në këtë apartament. Për këtë arsye, bashkëshorti i saj i ka kërkuar investitorit që të bëhej e mundur kalimi sa më shpejt në këtë banesë, ndonëse bisedimet për të marrë një apartament ishin realizuar vetëm me një marrëveshje paraprake verbale, ku kishin rënë dakord për çmimin dhe mënyrën e likuidimit të vlerës. Në vijim, deklaroi se investitori i ndërtesës, duke marrë në konsideratë kërkesën, ka lidhur kontratën e energjisë elektrike direkt në emrin e bashkëshortit të saj, me konsensusin e tij, por ka filluar të banojë në atë banesë, vetëm në mars të vitit 2009. Në vijim, shpjegon se

¹⁵Udhëzimi nr. 3, datë 3.2.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2010”.

¹⁶E-mail, datë 5.7.2021.

¹⁷Shkresat nr. *** prot., datë 20.1.2020 dhe nr. *** prot., datë 22.9.2021, bashkëlidhur procesverbali i datës 16.9.2021.

¹⁸E-mail, datë 20.10.2021.

¹⁹E-mail, datë 27.10.2021.

nga konsumimi i energjisë elektrike, rezulton që deri në mars të vitit 2009, ky konsum ka qenë 0 (zero), pra, nuk ka gjeneruar asnjë shpenzim, çka vërteton se në atë banesë nuk ka banuar askush. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. *** rep., datë 27.10.2021, të shtetasit M.M., i cili deklaroi se kontrata e energjisë elektrike me z. A.D. është lidhur në vitin 2008, përpara kontratës së sipërmarrjes dhe për shkak të njohjes personale kanë bërë marrëveshje paraprake verbale, ku kanë rënë dakord për vlerën e apartamentit dhe mënyrën e likuidimit.

2.8. Nga informacioni i administruar nga FSHU-ja²⁰, lidhur me faturimet për periudhën tetor 2008 – mars 2009, konstatohet se bashkëshorti i subjektit është faturuar në nëntor/2008 në shumën 5.400 lekë, nuk figuron faturimi për dhjetorin/2008 dhe më pas figuron faturimi, për janarin/2009 në shumën 403 lekë, për shkurtin/2009 në shumën 420 lekë dhe nga marsi/2009 vijon faturimi sipas konsumit normal të një familjeje.

2.9. Komisioni hetoi nëse në emër të shtetasit M.M., shoqërisë “****” sh.p.k. dhe ortakeve të saj ka pasur ndonjë proces gjyqësor për pasurinë nr. ***, z. k. ***, Shkodër. Nga informacioni i administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër²¹ nuk rezulton të ketë pasur ndonjë proces gjyqësor me këto palë për këtë pasuri. Gjithashtu, Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasin M.M., shoqërinë “****” sh.p.k., administratorin dhe ortakët A.G., G.N.G., P.N.G. dhe Sh.H. dhe nga informacioni i administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër²² nuk rezultoi që subjekti të ketë gjykuar çështje gjyqësore me këto palë.

2.10. Komisioni mori në shqyrtim deklaratimet e interesave private dhe pasurore të paraqitura më parë nga subjekti në ILDKPKI dhe rezultoi se subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në DIPP-në e vitit 2009, duke deklaruar: “*Apartament banimi me sipërfaqe prej 104 m² me adresë lagjja ‘***’, rruga ‘***’, me vlerë 4.680.000 lekë, me pjesë 1/2*”. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, por ka deklaruar: “*Nga vlera totale është likuiduar investitori në vlerën prej 2.180.000 lekësh*”, si dhe nuk ka deklaruar detyrime financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë në vlerën 2.500.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2010 ka deklaruar: “*Për pasurinë e paluajtshme apartament banimi i deklaruar dhe në deklaratën e një viti më përpara është mbajtur kontratë shitjeje nr. ***, datë 29.3.2010, në mes shitësit investitor dhe pronar i truallit M.M., bashkëshortit tim A.D. Është likuiduar edhe vlera prej 2.000.000 lekësh*”. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit të shumës së paguar, si dhe detyrimet financiare ndaj personave fizikë e juridikë në shumën 500.000 lekë. Gjithashtu, subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2010, 2011, 2012 dhe 2013, detyrimin ndaj shtetasit M.M., në shumën 500.000 lekë.

2.11. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimet: (i) subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, të drejtën reale të përdorimit të apartamentit me adresë lagjja “****”, rruga “****”, në kundërshtim me germën “a”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003; (ii) deklarimi i subjektit në

²⁰Shkresë nr. *** prot., datë 15.11.2021.

²¹Shkresë nr. *** prot., datë 28.6.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

²²Shkresë nr. *** prot., datë 28.6.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

deklaratën *Vetting* nuk është i saktë dhe në përputhje me detyrimin e përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 1 të nenit 31 dhe shtojcën nr. 2, të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë apartament me sip. 104 m²; (iii) deklarimi i subjektit në DIPP-në e vitit 2009 nuk është i saktë dhe në përputhje me paragrafin e parë dhe germën “dh”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të shumës 2.180.000 lekë, për pagimin e kështit të blerjes së pasurisë apartament me sip. 104 m² dhe detyrimin ndaj shtetasit M.M. në vlerën 2.500.000 lekë; (iv) deklarimi i subjektit në DIPP-në e vitit 2010 nuk është si saktë dhe në përputhje me paragrafin e parë të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të shumës 2.000.000 lekë, për pagimin e kështit të blerjes së pasurisë apartament me sip.104 m²; (v) deklarimi i subjektit në DIPP-të e viteve 2010, 2011, 2012 dhe 2013, nuk është i saktë dhe në përputhje me germën “dh”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, pasi nuk ka deklaruar detyrimin e ndaj shtetasit M.M., në shumën 500.000 lekë; (vi) çmimi i referencës për këtë apartament rezulton të jetë më i lartë se çmimi i blerjes sipas kontratës.

2.12. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²³, subjekti i rivlerësimit dha këto shpjegime:

2.12.1. *Lidhur me mosdeklarimin në DIPP-në e vitit 2008 të të drejtave reale mbi apartamentin* shpjegon se ka filluar të jetojë në banesën e mësipërme në mars të vitit 2009, periudhë në të cilën bashkëshorti kishte rënë dakord verbalisht me investitorin dhe, njëkohësisht, banesa ishte thujse gati për banim, pavarësisht se mes tyre nuk ishte realizuar ende kontrata e sipërmarrjes. Deri në mars të vitit 2009, nuk ka ushtruar asnjë lloj tagri pronësie lidhur me këtë pasuri (zotëruar, gëzuar apo përdorur) për qëllime banimi dhe, si pasojë, nuk kishte çfarë të deklaronte në DIPP-në e vitit 2008. Në vijim, subjekti shpjegon se investitori i ndërtesës së banimit, duke marrë në konsideratë kërkesën e tyre, ka lidhur kontratën e energjisë elektrike direkt në emrin e të ndjerit (bashkëshortit të subjektit) përpara se të hynin dhe të banonim në këtë apartament, me konsensusin e këtij të fundit, por që nga momenti i lidhjes së kontratës energjisë e deri në mars të vitit 2009, nuk rezulton të jetë konsumuar energji elektrike, çka del si fakt edhe nga aktet shkresore të OSHEE-së, ku rezulton që deri në mars të vitit 2009, ky konsum ka qenë (0) zero.

2.12.2. *Lidhur me mosdeklarimin e burimit të krijimit të pasurisë apartament me sip. 104 m² në deklaratën *Vetting* të vitit 2017,* shpjegon se është e pa qëllimshme, pasi duke deklaruar të ardhurat e krijuara në rubrikën e deklaratave vjetore, nga aktiviteti privat i bashkëshortit si inxhinier projektues për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011, mendonte se e kishte ezauruar dhe burimin e pagimit të kësteve dhe në këtë mënyrë dhe deklarimin e burimit të të ardhurave.

2.12.3. *Lidhur me konstatimin se në DIPP-të e viteve 2010, 2011, 2012 dhe 2013, nuk ka deklaruar detyrimin ndaj shtetasit M.M., në shumën 500.000 lekë,* subjekti i rivlerësimit prapëson se ka menduar se me deklarimin e pagimit të dy kësteve, sikundër ishte e përcaktuar dhe pasqyruar në kontratë dhe të deklaruar prej saj, evidentohet detyrimi i mbetur, duke gjykuar që diferenca e pashlyer është një vlerë automatikisht detyrim i mbetur ndaj shitësit të apartamentit. Pasi është sqaruar më hollësisht në ILDKPKI, i është thënë se duhet deklaruar çdo vit si detyrim i mbartur dhe në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP-të e viteve 2014, 2015,

²³E-mail, datë 23.12.2021.

2016, 2017 dhe 2018, ka deklaruar detyrimin e mbartur, në shumën 500.000 lekë. Kjo tregon dhe provon se kjo mënyrë të deklaruarit në vitet e mëparshme është i paqëllimtë dhe nuk ndikon në ligjshmërinë apo saktësinë e deklarimit.

2.12.4. *Lidhur me çmimin preferencial* shpjegon se referuar dosjes së lejes së ndërtimit të administruar pranë Bashkisë Shkodër, projekti së bashku me projektet e apartamenteve të kësaj godine, janë hartuar dhe realizuar nga bashkëshorti i subjektit. Si rezultat i këtij kontributi kanë rënë dakord me investitorin për një çmim preferencial. Gjithashtu, sqaron se sipas udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008, për vitin 2008, çmimi i tregut të lirë të apartamenteve, për rrethin e Shkodrës, shkon në vlerën prej 49.540 lekë/m², pra, një shumë pak a shumë e përafërt me çmimin e blerjes së këtij apartamenti. I referohet këtij udhëzimi, të vitit 2008, pasi është rënë dakord për marrjen e këtij apartamenti, që në vitin 2008, pavarësisht se konkretizimi formal i kësaj marrëdhënieje është bërë në vitin 2010. Për vërtetimin e këtyre rrethanave, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 21.12.2021, të shtetasit M.M., që ndër të tjera, deklaroi se: “... si çmim për m², i këtij apartamenti të porositur paraprakisht nëpërmjet marrëveshjes verbale është 45.000 lekë për m²... ky është çmim preferencial ofruar prej meje të ndjerit A.D. pasi ky i fundit ka kontribuar profesionalisht vetëm miqësisht në kryerjen e projektit” dhe kopje të dosjes së “lejes së ndërtimit”, të marrë nga Bashkia Shkodër.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.13. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyetoi se:

Lidhur me mosdeklarimin në DIPP-në e vitit 2008 të të drejtave reale mbi apartamentin

2.14. Në analizë të shpjegimeve të subjektit, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i qartë në prapësimet e tij, pasi Komisioni në asnjë rast nuk vuri në dyshim se ai të ketë filluar të banojnë në apartamentin objekt vlerësimi që në momentin e lidhjes së kontratës së energjisë elektrike në emër të bashkëshortit, por se nga hetimi i kryer rezultoi se kontrata për energjinë elektrike për këtë pasuri të jetë lidhur në emër të bashkëshortit përpara nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes. Nisur nga kjo rrethanë, Komisioni konstatoi se marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur me investitorin, ka nisur para nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, vërtetuar kjo me nënshkrimin e kontratës me OSHEE-në në tetor të vitit 2008.

2.15. Në këto kushte, trupi gjykues, në lidhje me shpjegimet e dhëna nga subjekti për mospërputhjen e datës së kontratës me OSHEE-në me atë të sipërmarrjes, vlerëson se subjekti nuk shpjegoi bindshëm se nuk e zotëronte apartamentin më parë se data e kontratës së sipërmarrjes, në konsideratë të faktit se: (i) në nëntor të vitit 2008, ky apartament kishte pasur faturim nga OSHEE-ja, në shumën 5.400 lekë; si dhe (ii) lidhja e kontratës me OSHEE-në, sipas legjislacionit të kohës, ka pjesë përbërëse edhe një kopje të dokumentit të pronësisë, qirasë apo sipërmarrjes, me qëllim që të lidhë kontratën e furnizimit me energji elektrike. Për

rrjedhojë, pretendimi i subjekti se investitori i ndërtesës së banimit, duke marrë në konsideratë kërkesën e tyre, ka lidhur kontratën e energjisë elektrike direkt në emrin e të ndjerit (bashkëshortit të subjektit) përpara se të hynin dhe të banonim në këtë apartament është i pabazuar në ligj dhe në prova. Për pasojë, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin interesat pasuror mbi këtë pasuri në DIPP-në e vitit 2008, e analizuar kjo në funksion të kohës se kur është kryer pagesa e këstit të parë për këtë apartament të deklaruar në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, duke u gjendur në kushtet e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me çmimin preferencial në blerjen e pasurisë apartament me sip. 104 m²

2.16. Komisioni arsyeton se nga hetimi administrativ rezulton se bashkëshorti i saj i ndjerë është projektues i pallatit ku ndodhet apartamenti në pronësi të subjektit. Gjithashtu, Komisioni nuk konstaton ndonjë diferencë të arsyeshme ndërmjet çmimit mesatar të shitjes së apartamenteve në tregun e lirë në qytetin e Shkodrës, për vitin 2010²⁴ me çmimit i blerjes së apartamentit për ta konsideruar atë si trajtim preferencial. Si pasojë, Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me çmimin e blerjes së pasurisë apartament me sip. 104 m².

*Lidhur me mosdeklarimin e burimit të krijimit të pasurisë apartament me sip.104 m² në deklaratën *Vetting* të vitit 2017*

2.17. Komisioni arsyeton se bazuar në pikat 1 dhe 2, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të dorëzojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin, me qëllim që t’i nënshtrohet kontrollit të pasurisë, për të verifikuar nëse ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose nëse i ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur. Ligji nr. 84/2016, në nenet 30 dhe 31, pika 1, përcakton detyrimin e subjektit të rivlerësimit, jo vetëm të deklarojë pasuritë, por dhe burimin e krijimit të tyre, me qëllim që t’i nënshtrohet kontrollit të burimeve të krijimit të pasurive në pronësi apo përdorim. Formulari i deklarimit të pasurisë së rivlerësimit, i parashikuar në shtojcën 2, të ligjit nr. 84/2016, në faqen 5, pasqyron në mënyrë të qartë se deklarimi i pasurisë shoqërohet me deklarimin e burimit të krijimit të saj. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë në deklaratat periodike, deklarimi për efekt të procesit të rivlerësimit merr një vlerë të posaçme, si baza e vetme e informacionit, mbi të cilin fillon hetimi administrativ. Në mungesë të deklarimit të burimit edhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, identifikimi i burimit dhe, më tej, vërtetimi i saktësisë së tij mbetet objekt i hetimit administrativ.

Në përfundim, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti ka bërë deklarim të pasaktë në DIPP-të për vitet 2009 dhe 2010, si dhe në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, në lidhje me burimet e krijimit të kësaj pasurie, duke vështirësuar punën e Komisionit për analizimin e burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie në vitin 2009 dhe 2010. Për këtë arsye, subjekti gjendet në kushtet e një deklarimi të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, sipas parashikimeve të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

²⁴Udhëzimi nr. 3, datë 3.2.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, për vitin 2010”.

Lidhur me mosdeklarimet në DIPP-të e viteve 2009 dhe 2010 të burimit të krijimit të shumave për shlyerjen e kësteve të blerjes së apartamentit dhe mosdeklarimit në DIPP-të e viteve 2010, 2011, 2012 dhe 2013, detyrimin ndaj shtetasit M.M., në shumën 500.000 lekë

2.18. Komisioni arsyeton se neni 4 i ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, (ref. ligji nr. 9049/2003), parashikon se: “*Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si vijon: [...] (dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj; e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale [...]. Në vijim, neni 21 përcakton se “[...] Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore) [...]”.* Nga analizimi i kësaj dispozite, evidentohet qartë se përveç deklarimit të të ardhurave të realizuara nga bashkëshorti nga aktiviteti si person fizik, subjekti ka pasur detyrimin për deklarimin e burimit të krijimit të shumave për pagimin e kësteve të blerjes së apartamentit në DIPP-të e viteve 2009 dhe 2010, si dhe detyrimet financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se mosdeklarimet e konstatuara në deklaratat e interesave private periodike/vjetore dhe deklaratën në *Vetting* të vitit 2017, lidhur me burimin e krijimit të shumave të paguara për blerjen e apartamentit në vitet 2009 dhe 2010, si dhe të detyrimit ndaj shtetasit M.M. në DIPP-të e viteve 2010, 2011, 2012 dhe 2013, janë vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

2.19. Në përfundim, Komisioni arrin në konkluzionin se: (i) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, *Vetting* 2017, në kundërshtim me parashikimin e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë apartament me sip. 104 m²; (ii) mosdeklarimet e konstatuara në deklaratat e interesave private periodike/vjetore të burimit të krijimit të shumave për pagimin e kësteve të blerjes së apartamentit dhe të detyrimit ndaj shtetasit M.M. janë vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

2.20. Në kushtet kur subjekti nuk kishte deklaruar burimet e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 dhe në DIPP-të për vitet 2009 dhe 2010, Komisioni analizoi mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e të ardhurave për pagimin e kësteve të blerjes së apartamentit, sipas deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ, si vijon:

2.21. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1²⁵, i kërkoi subjektit të deklaronte: (i) burimin e krijimit të shumave të paguara për apartamentin; (ii) nëse likuidimet ishin kryer *cash* apo me bankë dhe të specifikonte datat e sakta për pagesën e secilit këst, duke paraqitur dokumentacion ligjor justifikues; (iii) nëse ishte likuiduar detyrimi ndaj shtetasit M.M., në shumën 500.000 lekë, për blerjen e apartamentit.

²⁵E-mail, datë 20.10.2021.

2.22. Në përgjigje²⁶, për sa i përket burimit të krijimit, subjekti deklaroi se burimi i të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti janë të ardhurat nga aktiviteti i ligjshëm privat i të ndjerit A.D. (bashkëshorti), aktivitet ky i regjistruar më 16.5.2008, pranë Regjistrat Tregtar, me NIPT ***, si person fizik, me aktivitet “zhvillimi i projekteve për pasuritë e patundshme”. Me deklarin e të ardhurave të krijuara nga aktiviteti privat i bashkëshortit për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011, vijoi subjekti, është ezauruar edhe deklarimi mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe se nuk do të kishte arsye përse mos të deklaronte këtë burim krijimi, për sa kohë që kanë qenë të ardhura të ligjshme, të krijuara nga puna dhe aktiviteti profesional i bashkëshortit.

2.23. Subjekti, lidhur me datat e pagesës, deklaroi se pagesa e kështit të parë në shumën 2.180.000 lekë është kryer *cash* në momentin që janë vendosur në banesë për të jetuar në mars të vitit 2009 dhe pagesa e kështit të dytë prej 2.000.000 lekësh, është likuiduar *cash* ditën e nënshkrimit të kontratës më 29.3.2010, siç citohet edhe në kontratën e sipërmarrjes.

2.24. Lidhur me detyrimin e mbetur në shumën 500.000 lekë, deklaroi se kjo shumë është likuiduar në vitin 2021, fakt që pasqyrohet në përmbajtje të kontratës përfundimtare të shitjes, datë 17.7.2021, të lidhur mes sipërmarrësit M.M. (së bashku me bashkëshorten e tij F.M.) dhe palë blerëse Ermira Dedja, G.D. dhe R.D. (në cilësinë e trashëgimtarëve). Për vërtetimin e këtij deklarimi ka paraqitur edhe dokumentacionin provues²⁷.

Analiza financiare e kryer nga Komisioni gjatë hetimit

2.25. Nga shqyrtimi i DIPP-ve të viteve 2008, 2009 dhe 2010, Komisioni konstaton se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë deklaruar likuiditete apo gjendje *cash* jashtë sistemit bankar. Për rrjedhojë, Komisioni kreu analizën financiare për verifikimin e burimeve të ligjshme financiare për vlerën 2.180.000 lekë, për periudhën 1.1.2009 - 31.3.2009, si dhe vlerën 2.000.000 lekë, për periudhën 1.1.2010 – 29.3.2010, referuar burimit të krijimit të deklaruar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1, pra, të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit të analizuar në vijim.

Të ardhurat totale nga aktiviteti si person fizik i bashkëshortit të subjektit

2.26. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti ka deklaruar të ardhura nga biznesi i bashkëshortit si inxhinier projektues në vlerën 8.817.454 lekë dhe ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 25.1.2017, nga DRT-ja Shkodër, ku është përcjellë informacion lidhur me të ardhurat, shpenzimet tatimore dhe fitimin e tatueshëm për vitet 2008, 2009 dhe 2010, ndërsa për vitin 2011, shitjet e tatueshme sipas deklaratave të TVSH-së rezultojnë në vlerën 1.333.333 lekë, ndërsa sigurimet shoqërore në shumën 63.144 lekë.

2.27. Në DIPP-të vjetore ka deklaruar të ardhura nga biznesi i bashkëshortit si projektues, konkretisht: në shumën 4.184.065 lekë për vitin 2008; në shumën 3.076.736 lekë për vitin 2009; në shumën 1.012.544 lekë për vitin 2010; si dhe në shumën 1.333.333 lekë për vitin 2011.

²⁶E-mail, datë 27.10.2021.

²⁷Kontratë nr. ***, datë 17.7.2021.

2.28. Në përgjigje të pyetësorit standard²⁸, subjekti ka deklaruar se ka përfituar të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortit, në vlerën 8.817.454 lekë, me këtë përlllogaritje: “Për vitin 2008, vlera 3.765.659 lekë; për vitin 2009, vlera 2.769.062 lekë; për vitin 2010, vlera 1.012.544 lekë; për vitin 2011, vlera 1.270.189 lekë”.

2.29. Komisioni hetoi lidhur me aktivitetin privat të bashkëshortit të subjektit dhe nga informacioni i përcjellë nga QKB-ja²⁹ rezulton se shtetasi A.D. është regjistruar për herë të parë si person fizik më 19.5.2008 me fushë veprimtarie “inxhinier-arkitekt” dhe më 3.8.2012 është çregjistruar. DRT-ja Shkodër³⁰ informon se fitimi tatimor i realizuar nga shtetasi A.D. është: (i) në vitin 2008, në vlerën 4.184.065 lekë; (ii) në vitin 2009, në vlerën 3.076.736 lekë; (iii) në vitin 2010, në vlerën 1.136.382 lekë; (iv) në vitet 2011 dhe 2012, vlera 0 (zero) lekë. Sipas informacionit të përcjellë rezulton se tatimi mbi të ardhurat të biznesit të vogël është paguar: në datën 31.3.2009, vlera 398.407 lekë; në datën 30.3.2010, vlera 277.673 lekë; si dhe në datën 31.3.2011, vlera 80.638 lekë.

2.30. Në dokumentacionin e administruar nga DRT-ja Shkodër³¹, në vitin 2011 u evidentua një shitje në shumën 1.600.000 lekë (vlerë totale me TVSH), me blerës shtetasin A.D. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1³², i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me këtë faturë. Në përgjigje³³, subjekti paraqiti kopje të njehsuar të kësaj fature, ku figuron blerëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe vërtetimi nga DRT-ja Shkodër³⁴, ku konfirmohet se kjo faturë është e deklaruar edhe nga blerësit dhe, gjithashtu, për këtë shitje është paguar tatimi mbi vlerën e shtuar nga subjekti tregtar “****”³⁵.

2.31. Referuar lëvizjeve të llogarive bankare konstatohet se likuidimi i kësaj fature është kryer në vitin 2011 (në vlerën 1.200.000 lekë) dhe në vitin 2012 (në vlerën 400.000 lekë).

2.32. Bashkia Shkodër³⁶ informon se subjekti tregtar “****” ka shlyer detyrime lokale³⁷, për periudhën 2008 – 2011, ndër të tjera, edhe taksën vendore të biznesit të vogël në vlerën 20.000 lekë për vitin 2008 dhe në vlerën 33.000 lekë/në vit për periudhën 2009 – 2011. Për vitin 2012 ky subjekt rezulton debitor deri në momentin e aplikimit për çregjistrim në QKB, datë 19.6.2012, në vlerën 20.400 lekë.

2.33. Sa më sipër, Komisioni përlllogariti fitimin *neto*, duke zbritur nga fitimi *bruto* taksën vendore të biznesit të vogël dhe tatimin mbi të ardhurat e biznesit të vogël (bazuar në vitin kur

²⁸E-mail, datë 2.7.2021.

²⁹Shkresë nr. **** prot., datë 5.2.2020.

³⁰Shkresë nr. **** prot., datë 30.6.2021.

³¹Shkresë nr. **** prot., datë 17.9.2021.

³²E-mail, datë 20.10.2021.

³³E-mail, datë 27.10.2021.

³⁴Shkresë nr. **** prot., datë 22.10.2021.

³⁵Shkresë nr. **** prot., datë 22.10.2021.

³⁶Shkresat me nr. **** prot., datë 22.9.2021 dhe nr. **** prot., datë 17.9.2021.

³⁷Për vitin 2008: “Tarifë pastrimi 10.000 lekë, taksë tabele 500 lekë, taksë ndërtese 4.500 lekë, tarifë gjelbërimi 1.000 lekë, tarifë ndriçimi 1.500 lekë, taksë vendore biznesi i vogël 20.000 lekë”; për vitin 2009: “Tarifë pastrimi 10.000 lekë, taksë tabele 500 lekë, taksë ndërtese 4.500 lekë, tarifë gjelbërimi 3.000 lekë, tarifë ndriçimi 3.000 lekë, taksë vendore biznesi i vogël 33.000 lekë”; për vitin 2010: “Tarifa të tjera 3.180 lekë, taksë tabele 120 lekë, taksë ndërtese 4.500 lekë, taksë vendore biznesi i vogël 33.000 lekë”; për vitin 2011: “Tarifa të tjera 3.180 lekë, taksë tabele 120 lekë, taksë ndërtese 4.500 lekë, taksë vendore biznesi i vogël 33.000 lekë”.

janë paguar), si dhe pasqyroj në analizën financiare fitimin *neto* që rezultoi nga këto përllogaritje.

Lidhur me këstin e parë në vlerën 2.180.000 lekë, në mars të vitit 2009

2.34. Komisioni, referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit dhe në mungesë të deklarimit të gjendjes së likuiditeteve *cash*, përllogariti fitimin *neto* nga aktiviteti si person fizik i bashkëshortit të subjektit për gjithë vitin 2009 dhe për periudhën janar-mars 2009 llogariti në mënyrë përpjesëtimore (3 muaj x 2.645.329 lekë/12 muaj), nga ku rezultoi vlera prej 661.332 lekësh. Për pasojë, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 1.518.666 lekë, për pagimin e kështit të parë në mars të vitit 2009, sipas deklarimit të subjektit gjatë hetimit.

Lidhur me këstin e dytë në vlerën 2.000.000 lekë, datë 29.3.2010

2.35. Komisioni, referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, duke qenë se subjekti nuk kishte deklaruar gjendjen e likuiditeteve në bankë apo *cash*, përllogariti fitimin *neto* nga aktiviteti si person fizik i bashkëshortit të subjektit, për periudhën janar-mars 2010, në mënyrë përpjesëtimore (3 muaj x 805.309 lekë/12 muaj), nga ku rezultoi vlera 201.327 lekë dhe, si pasojë, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 1.798.672 lekë, për pagimin e kështit të dytë në mars të vitit 2010, sipas kontratës.

2.36. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime në lidhje me konstatimin se: (i) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1.518.668 lekë, për pagesën e kështit të parë të apartamentit në mars të vitit 2009; si dhe (ii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1.798.672 lekë, për pagesën e kështit të dytë të apartamentit në datën 29.3.2010.

2.37. Në përgjigje të rezultateve të hetimit,³⁸ subjekti i rivlerësimit, për pagimin e kështit të parë në vlerën 2.180.000 lekë, në mars të vitit 2009, shpjegon se bashkëshorti ka zhvilluar një aktivitet privat, si person fizik, i regjistruar pranë organeve tatimore prej muajit maj të vitit 2008. Për shkak të natyrës të aktivitetit të tij, përllogaritja e fitimit *neto*, sikundër parashikohet nga legjislacioni fiskal, është kryer gjithmonë për çdo vit në muajin mars të vitit pasardhës dhe logjikisht fitimi *neto* i vitit 2008 është llogaritur dhe i është paguar tatimi mbi fitimin në mars të vitit 2009. Pikërisht në momentin e deklarimit në tatime dhe pagimit të detyrimeve tatimore përkatëse në muajin mars të vitit 2009, menjëherë pas kësaj, fitimi *neto* i përllogaritur është përdorur për pagesën e kështit të parë për blerjen e apartamentit. Në kushtet kur aktiviteti i bashkëshortit klasifikohet biznes i vogël (person fizik), nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor që të përgatiste apo të hartonte pasqyra financiare, si dhe të deklaronte gjendjen e arkës në fund të vitit. Gjithashtu, shpjegon se deri më 31.12.2008, nuk i dispononte këto të ardhura në banesë, as *cash* as si likuiditet, pasi ishin në arkën e aktivitetit të bashkëshortit dhe gjendja e likuiditetit nga fitimi të këtij aktiviteti përcaktohet në momentin e përmbylljes së llogaritjeve financiare në muajin mars të vitit pasardhës. Në vijim, shpjegon se dhe *për pagimin e kështit të dytë në*

³⁸E-mail, datë 23.12.2021.

vlerën 2.000.000 lekë, në datën 29.3.2010, duke përdorur të njëjtën logjikë si për pagesën e këstit të parë, është përdorur fitimi i realizuar në vitin 2009, prandaj dhe pagesat e dy kësteve për blerjen e apartamentit janë bërë në muajin mars të vitit 2009 dhe në mars të vitit 2010, pas përlllogaritjeve të fitimit të realizuar dhe pagimit të detyrimeve tatimore.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.38. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

Lidhur me pagesën e këstit të parë prej 2.100.000 lekësh në mars të vitit 2009 dhe këstit të dytë prej 2.000.000 lekësh në mars të vitit 2010

2.39. Në analizë të pretendimeve të subjektit se: (i) pikërisht në momentin e deklaratimit në tatime dhe pagimit të detyrimeve tatimore përkatëse në mars të vitit 2009 (për fitimet e vitit 2008) menjëherë pas kësaj, fitimi *neto* i përlllogaritur është përdorur për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit; dhe (ii) për pagimin e këstit të dytë në vlerën 2.000.000 lekë, në datën 29.3.2010, duke përdorur të njëjtën logjikë si për pagesën e këstit të parë, është përdorur fitimi i realizuar në vitin 2009, trupi gjykues çmon të marrë në analizë legjislacionin në fuqi të kohës lidhur me deklarin e interesave private.

Referuar germës “d”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, zyrtarët deklarues detyrohen të deklarojnë brenda datës 31 mars të çdo viti gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, si vijon: “[...] (d) vlerën e likuiditeteve, gjendje *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”.

Sipas kësaj dispozite, përcaktohet detyrimi i subjekteve deklaruese për të pasqyruar çdo ndryshim të interesave private në çdo deklarin periodik. Formulari i deklaratimit të pasurisë, i miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, përshkruan më tej mënyrën se si duhen deklaruar këto ndryshime, duke detyruar subjektet e deklaratimit të deklarojnë në mënyrë të qartë çdo shtesë apo pakësim, që përbën ndryshim të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme. Legjislacioni i sipërcituar përcakton detyrimin e zyrtarit deklarues të deklarojë gjendjen *cash* dhe jo të nënkuptohet ekzistenca e tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Në rastin konkret, fitimi i realizuar gjatë vitit 2008 në shumën 4.184.065 lekë, pavarësisht se kur deklarohet për efekt të legjislacionit tatimor, pjesa e pashpenzuar nga fitimet e vitit 2008 do të duhej të ishte deklaruar në DIPP-në e vitit 2008 si gjendje *cash*. Gjithashtu, fitimi i realizuar gjatë vitit 2009 në shumën 3.076.736 lekë, pavarësisht se kur deklarohet për efekt të legjislacionit tatimor, pjesa e pashpenzuar nga fitimet e vitit 2009 do të duhej të ishte deklaruar në DIPP-në e vitit 2009 si gjendje *cash*. Mosdeklarimi i vlerave të mësipërme në deklaratimet e interesave private si shtesa të likuiditeteve *cash* në banesë në fund të viteve 2008 dhe 2009, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, krijon bindjen se këto të ardhura nga aktiviteti privat i

bashkëshortit të subjektit këto vite nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për pagimin e kësteve të këtij apartamenti në mars të vitit 2009 dhe në mars të vitit 2010.

2.40. Komisioni, bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, arsyeton se likuiditetet dhe/ose gjendja *cash* jashtë sistemit bankar, shtesat dhe pakësimet e tyre, merren parasysh duke u bazuar në deklaratimet e subjektit dhe personave të lidhur në deklaratat periodike vjetore, deklarata të cilat përbëjnë provë për Komisionin, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

2.41. *Lidhur me pretendimin e subjektit se të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit ishin në arkën e aktivitetit të bashkëshortit dhe gjendja e likuiditetit nga fitimi përcaktohet në momentin e mbylljes së përlllogaritjeve financiare në muajin mars të vitit pasardhës dhe nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor të deklaronte gjendjen e arkës në fund të vitit*, Komisioni arsyeton se procesi i rivlerësimit është administrativ dhe kryhet mbi parimet e parashikuara në ligjin nr. 84/2016. Referuar dispozitave të ligjit nr. 84/2016³⁹, në procesin e rivlerësimit barra e provës është e zhvendosur te subjekti i rivlerësimit, pra, i përket këtij të fundit detyrimi për të provuar pretendimet e tij, duke paraqitur prova dhe fakte të nevojshme për këtë qëllim nga ato që parashikon neni 49 i këtij ligji. Gjithashtu, subjekti, gjatë hetimit administrativ dhe në përfundim të rezultateve të hetimit, nuk paraqiti provë që të provonte gjendjen e likuiditeteve të aktivitetit të bashkëshortit deri në datën e deklaratimit të të ardhurave në mars të vitit 2009 dhe në mars të vitit 2010, që përkojnë me shlyerjen e kësteve të blerjes së apartamentit të deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 1 dhe në përfundim të rezultateve të hetimit. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me gjendjen e likuiditeteve në arkën e aktivitetit të bashkëshortit, mbeten në nivel deklarativ të kryer pas prezantimit të gjetjeve të hetimit për mungesa të burimeve të ligjshme financiare.

2.42. Komisioni arsyeton se ekzistenca ose jo e detyrimit për dorëzimin e pasqyrave financiare nuk krijon pengesë për verifikimin gjendjen e likuiditeteve në arkën e njësisë ekonomike në një datë të caktuar. Ditari i arkës është një libër i kontabilitetit ku bëhet regjistrimi sistematik i të gjitha transaksioneve të arkëtimit dhe pagesave sipas radhës së tyre të ndodhjes, pra, në mënyrë kronologjike. Për rrjedhojë, deklarimi i subjektit se gjendja e likuiditetit nga fitimi të këtij aktiviteti nuk përcaktohet sa është, përveçse në momentin e përmblylljes së përlllogaritjeve financiare në muajin mars të vitit pasardhës, nuk është bindës për Komisionin. Në datën e plotësimit të DIPP-ve të viteve 2009 dhe 2010, subjekti e ka pasur të gjithë informacionin mbi fitimin e realizuar dhe gjendjen e likuiditeteve të datës 31 dhjetor.

2.43. Po kështu, në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 27.3.2015⁴⁰, e pyetur në lidhje me diferencën e pajustificuar të vitit 2010 për krijimin e pasurive *neto* në shumën 2.000.000 lekë, subjekti ka deklaruar: *“Kam deklaruar të ardhura nga bashkëshorti në shumën 1.012.544 lekë, por vërtetimi sqaron se të ardhurat kanë qenë në shumën 1.214.680 lekë”*. Pra, subjekti i është referuar të ardhurave nga aktivitetit të vitit 2010 dhe jo të ardhurave të vitit 2009, sikundër ka pretenduar gjatë prapësimeve.

³⁹Ligji nr. 84/2016, neni 52, parashikon: *“2. Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45 të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën”*.

⁴⁰Përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 5.7.2021.

2.44. Sa më sipër, në kushtet kur subjekti nuk paraqiti ndonjë provë të vërtetonte deklaramet lidhur me arkën e aktivitetit të personit fizik “****”, bashkëshorti i subjektit dhe gjendjen e likuiditeteve të aktivitetit të tij, Komisioni, bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, përlllogarit fitimin *neto* nga aktiviteti si person fizik në mënyrë përpjesëtimore për periudhat janar – mars 2009 dhe janar – mars 2010, që përkojnë me vitin financiar të të ardhurave të realizuara nga bashkëshorti i subjektit dhe rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur: (i) kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 1.518.666 lekë, për pagimin e këstit të parë në mars të vitit 2009; si dhe (ii) kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 1.798.672 lekë, për pagimin e këstit të dytë në mars të vitit 2010.

2.45. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur: (i) kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 1.518.666 lekë, për pagimin e këstit të parë në mars të vitit 2009; si dhe (ii) kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 1.798.672 lekë, për pagimin e këstit të dytë në mars të vitit 2010, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

3. Apartament banimi me sip. 80 m², në Shkodër, fituar me privatizim

3.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament banimi me sip. 80 m², në Shkodër, me vlerë privatizimi 20.412 lekë, me pjesë takuese ¼, duke tërhequr edhe të drejtën pasurore të nënës së saj të ndjerë. Si burim krijimi ka deklaruar fitimin me privatizim sipas akt shitblerjeje pasurie, nr. ***, datë 5.7.1993, si dhe trashëgimia e nënës. Për vërtetimin e deklaramet, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁴¹.

3.2. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Shkodër⁴², rezultoi se në bashkëpronësi të shtetasve H.K., A.K., M.K. dhe E.K. është regjistruar pasuria e llojit apartament, me sip. 80 m², nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***. Kjo pasuri rezulton të jetë regjistruar në bazë aktit të shitblerjes së paluajtshme nr. ***, datë 5.7.1993, lidhur ndërmjet Sektorit të Privatizimit të Ndërmarrje Komonale Banesave dhe shtetasve H.K., M.K., E.K. e A.K., kundrejt çmimit të shitjes 20.412 lekë.

3.3. Sipas certifikatës së martesës të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, rezulton se subjekti përpara martesës ka pasur mbiemrin K. dhe pas martesë ka marrë mbiemrin e bashkëshortit, Dedja.

3.4. Nga hetimi administrativ, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni konstaton se deklaramet i subjektit është i saktë dhe përputhet me dokumentacionin justifikues.

⁴¹Certifikatë nr. ***, datë 26.10.2012, e pasurisë nr. ***, z. k. ***, në pronësi të shtetasve H.K., M.K., E.K. dhe A.M.; hartë treguese datë 9.10.2012; kartelë e pasurisë së paluajtshme të pasurisë nr. ***, z. k. ***, certifikatë familjare; pasqyrë e llogarisë së tatimit nga rivlerësimi; formular aplikimi, datë 29.8.2012, për rivlerësim të pasurisë së paluajtshme; formular nr. 3, kontratë për privatizimin e banesës; akt shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 5.7.1993.

⁴²Shkresë nr. *** prot., datë 25.2.2020; kartelë e pasurisë së paluajtshme nr. ***, z. k. ***, shkresë nr. *** prot., datë 18.5.2012; kërkesë e shtetasit H.K.; formular nr. 2, datë 7.6.1993, treguesit kryesor të apartamentit; formular nr.1, datë 7.6.1993, treguesit tekniko-ekonomikë të banesës; certifikatë familjare e datës 8.4.1993; planimetri apartamenti; genplan; certifikatë pronësie nr. ***, datë 26.10.2012, e pasurisë nr. ***, në emër të shtetasve H. M.K., E.K. dhe A.M.; formulari nr. 3, kontratë për privatizimin e banesës; akt shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 5.7.1993.

3.5. Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit është i saktë në përputhje me ligjin, duke plotësuar kushtin e parashikuar në germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

4. Automjet tip “Volkswagen Golf”, në vlerën 250.000 lekë

4.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjet tip “Volkswagen Golf”, fituar me kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 22.3.2007, me vlerë 250.000 lekë dhe zhdoganim në vlerën 976.652 lekë⁴³. Fillimisht me pjesë takuese 50% dhe pas vdekjes së bashkëshortit 1/6 pjesë ideale në bashkëpronësi me dy fëmijët. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Për vërtetimin e deklaramit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁴⁴.

4.2. Nga shqyrtimi i deklaratës *Vetting* të vitit 2017 dhe i DIPP-së së vitit 2007, vit kur është krijuar kjo pasuri, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit.

4.3. Nga dokumentacioni i administruar nga DPSHTRR-ja⁴⁵, rezultoi se sipas kontratës së shitjes së automjetit nr. ***, datë 22.3.2007, shtetasi A.D. ka blerë nga shtetasi V.D. automjetin tip “Volkswagen Golf”, me targa ***, kundrejt çmimit 250.000 lekë, pa doganë. Në kontratë përcaktohet se çmimi i blerjes së automjetit është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në deklaratën doganore nr. ***, datë 23.3.2007, ku figuron si eksportues shtetasi V. D. dhe importues shtetasi A.D.⁴⁶, pasqyrohet çmimi 2.500 euro dhe detyrimet doganore në shumën 164.095 lekë⁴⁷. Gjithashtu, në dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR-ja është administruar një deklaratë shitjeje, pa numër apo datë, ku shtetasi A.M., rezident në Itali, i shet shtetasit V.D. automjetin tip “Volkswagen Golf”. Në këtë deklaratë nuk është përcaktuar çmimi i shitjes. Më pas (nga dokumentacioni i administruar nga notere M.N.⁴⁸), rezulton se shtetasit Ermira Dedja, G.D. dhe R.D. e kanë shitur këtë automjet kundrejt vlerës 1.100 euro shtetasit A.Rr., me kontratën nr. ***, datë 14.4.2021.

4.4. Komisioni hetoi për konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër⁴⁹ lidhur me proceset gjyqësore të gjykuara në këtë gjykatë me palë shtetasin V.H.D. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër⁵⁰

⁴³Në pyetësorin nr. 1 subjekti ka sqaruar se deklarimi në deklaratën *Vetting* i vlerës doganore është një lapsus, pasi ka shtuar gabimisht një numër 6 në shifrën e paguar *cash* në bankë që është 97.652 lekë.

⁴⁴Shkresë nr. *** prot., datë 24.1.2017, nga DRSHTRR-ja, për dosjen e automjetit me targa ***; kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 22.3.2007; vërtetim zhdoganimi datë 23.3.2007; deklaratë doganore datë 23.3.2007, në emër të shtetasit V.D.; dokument në gjuhën italiane; certifikatë qarkullimi mallrash automjeti në gjuhën italiane; dokument në gjuhën italiane (*cerificato di proprieta*); deklaratë doganore datë 23.3.2007, në emër të shtetasit V.D.; dokument në gjuhën italiane (*dichiarazione di vendita*); depozitë *cash* nr. ***, në vlerën 67.000 lekë, në UBA Bank; depozitë *cash* nr. ***, në vlerën 66.442 lekë, në UBA Bank, nga shtetasi A.D.

⁴⁵Shkresë nr. *** prot., datë 9.7.2021.

⁴⁶Importues individual, detajuar në kutinë nr. *** të deklaratës doganore.

⁴⁷Vërtetuar edhe me dokument “depozitë në *cash* nr. ***”, datë 23.3.2007 dhe “depozitë në *cash* nr. ***”, datë 23.3.2007, të UBA Bank, me anë të të cilave shtetasi A.D. i ka paguar degës së doganës Shkodër përkatësisht shumën 97.652 lekë dhe shumën 66.442 lekë.

⁴⁸Shkresë nr. *** prot., datë 28.6.2021.

⁴⁹Shkresë nr. *** prot., datë 1.7.2021.

⁵⁰Shkresë nr. ***, datë 9.7.2021.

informon se nuk rezulton të ketë çështje të regjistruara pranë kësaj gjykate në emër të shtetasit V.H.D.

4.5. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1⁵¹, i kërkoi subjektit të deklarojë burimin e krijimit të këtij automjeti. Në përgjigje të saj⁵², subjekti ka deklaruar se burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit ka qenë depozita me afat që kishin vendosur në Bankën e Tiranës në vitin 2006, e cila është tërhequr 3 muaj pas lidhjes së kontratës për blerjen e automjetit. Subjekti ka shpjeguar se i ndjeri, bashkëshorti i saj, për të mos humbur interesat nga depozita me afat njëvjeçar, u ndihmua nga kunati, vëllai i subjektit, shtetasi A. (K.) M., i cili e ndihmoi bashkëshortin për një afat të shkurtër, rreth 3 muaj dhe me mbushjen e afatit është tërhequr shumta e depozitës për të shlyer vëllain e saj. Për vërtetimin e deklaratimit, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. *** rep., datë 27.10.2021, të shtetasit A.M., i cili deklaron se: *“...kam mbështetur financiarisht të ndjerin A.D., bashkëshort i motrës time, për blerje të pasurisë së luajtshme...(afërsisht në fillim të vitit 2007) autoveturën e markës ‘Volkswagen’ tip ‘Golf’, me ngjyrë blu, në shumën 395.000 lekë...”*. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e ligjshme të shtetasit A.M.

4.6. Nga hetimi administrativ, Komisioni vëren se në datën 23.3.2007, përveç depozitës bankare, e cila në këtë datë ka pasur një balancë prej 650.668 lekësh, subjekti ka pasur gjendje në llogarinë rrjedhëse në Bankën e Tiranës vlerën prej 426.575 lekësh, e mjaftueshme për pagesën e automjetit.

4.7. Komisioni, bazuar në dokumentacionin e administruar, ka marrë në konsideratë në analizën financiare çmimin e automjetit, sipas të dhënave të deklaratës doganore, pra, vlerën 315.000 lekë⁵³. Po kështu, u pasqyrua si shpenzim edhe pagesa e detyrimeve doganore në vlerën 164.095 lekë.

4.8. Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat, shpenzimet, detyrimet dhe pasuritë e subjektit, personave të lidhur, si dhe vjehrrës së saj për shkak të jetesës së përbashkët, deri më 23.3.2007, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 674.446 lekë, në datën 23.3.2007, për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve.

4.9. Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimet se: (i) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 674.446 lekë, në datën 23.3.2007, për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve; (ii) deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* nuk është i saktë dhe në përputhje me detyrimin e përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 1, të nenit 31, dhe shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë automjet; si dhe (iii) deklarimi i subjektit në DIPP-në

⁵¹E-mail datë 20.10.2021.

⁵²E-mail datë 27.10.2021.

⁵³Vlera 2.500 euro, e vlerësuar me kursin e këmbimit 1 euro = 126 lekë, të pasqyruar në deklaratën doganore.

e vitit 2007 nuk është i saktë dhe në përputhje me paragrafin e parë të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të automjetit.

4.10. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁵⁴, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo pasuri është fituar nëpërmjet kontratës së shitjes së automjetit nr. ***, datë 22.3.2007, me vlerë 250.000 lekë. Në kontratën e shitblerjes është përcaktuar se çmimi i shitjes së automjetit nuk përfshin doganën, pra, rrjedhimisht, dogana do të paguhej nga blerësi, bashkëshorti i ndjerë A.D. Vlera e zhdoganimit të automjetit rezulton nga deklarata doganore dhe ka shkuar në shumën prej 164.905 lekësh. Çmimi i deklaruar nga shitësi në deklaratën doganore në vlerën 2.500 euro është vlerë që shërben për referencë për qëllim të pagimit të taksës doganore. Ndërsa, *lidhur me burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie*, subjekti ka shpjeguar se burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit nga bashkëshorti ka qenë depozita me afat që kishte vendosur në Bankën e Tiranës në vitin 2006, që është tërhequr 3 muaj pas lidhjes së kontratës për blerjen e automjetit. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se bashkëshorti, për të mos humbur interesat nga depozita me afat njëvjeçar, u ndihmua nga vëllai i saj A.M. (K.). Me plotësimin e afatit është tërhequr shuma e depozitës për të shlyer vëllain e subjektit po brenda vitit. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se lidhur me dhënien e huas nga i vëllai është vënë në dijeni vetëm kohët e fundit për shkak të grumbullimit të informacionit për qëllim të procesit të rivlerësimit. *Lidhur me burimin e të ardhurave të vëllait të saj A.M. (K.)*, subjekti ka sqaruar se në atë periudhë ka qenë emigrant në shtetin italian dhe ka dorëzuar aktet ligjore që ka arritur të sigurojë nga aktiviteti sezonal që ka ushtruar në këtë shtet, duke sqaruar se në momentin më të parë të mundshëm këto dokumente do t'i paraqesë edhe me vulën apostile⁵⁵.

4.11. Më tej, në dokumentin “raport mbi procedurat e rëna dakord”, lëshuar nga audituesi ligjor H. K. (M.)⁵⁶, subjekti ka paraqitur analizën financiare, me balancë negative në vlerën 19.615 lekë, ku pasqyrohet ndryshimi i çmimit të automjetit, paraqitja e të ardhurave nga paga të subjektit (përkundrejt metodikës së përdorur nga Komisioni me tërheqjet nga llogaria bankare), saktësimin e shpenzimeve të jetesës, huan nga vëllai, reduktimin e shpenzimeve jashtë vendit dhe të detyrimeve doganore të paguara për zhdoganimin e automjetit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

4.12. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratën e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratat në seancë dëgjimore, arsyeton se:

4.13. *Lidhur me çmimin e automjetit*, Komisioni i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit dhe për këtë arsye, për efekt të analizës financiare, u konsiderua çmimi 250.000 lekë, bazuar në

⁵⁴E-mail datë 23.12.2021.

⁵⁵Në përgjigje të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, subjekti ka paraqitur: ekstrakt INPS (Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore), ku pasqyrohen të ardhurat për periudhat 1999 – 2004 dhe 2005 – 2010; CUD për vitet 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007 dhe 2008; lëvizjet e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”, valuta në euro, për periudhën 17.11.2006 – 10.1.2022.

⁵⁶Paraqitur nga subjekti në seancë dëgjimore.

kontratën e shitjes së automjetit nr. ***, datë 22.3.2007, si dhe shpenzimet e zhdoganimit në vlerën 164.905 lekë.

4.14. Lidhur me mosdeklarimin e burimit të krijimit të shumës për blerjen e automjetit, Komisioni arsyeton se mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurisë së luajtshme automjet në DIPP-në e vitit 2007, vjen në kundërshtim me paragrafin e parë të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar. Gjithashtu, mosdeklarimi i burimit të krijimit të kësaj pasurie edhe në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 vjen në kundërshtim me detyrimin e përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të nenin D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 1, shtojca 2, të nenit 31, të ligjit nr. 84/2016. Si pasojë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimin e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

4.15. Lidhur me huan e dhënë nga shtetasi A.M. (K.), Komisioni arsyeton subjekti nuk e ka deklaruar marrëdhënien e huas as në DIPP-në e vitit 2007 dhe as në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, por e ka deklaruar për herë të parë gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 1⁵⁷. Në pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet: “[...] 5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit”. Bazuar në këtë dispozitë ligjore, deklarata e interesave private vjetore periodike është një burim i rëndësishëm prove në procesin e rivlerësimit.

4.16. Lidhur me deklaratën noteriale nr. *** rep., datë 27.10.2021, të shtetasit A.M., të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të provuar marrëdhënien e huas, Komisioni sjell në vëmendje qëndrimet që ka mbajtur Kolegji i Posaçëm i Apelit në jurisprudencën e tij në çështje të ngjashme, sipas të cilave deklarata noteriale, megjithëse nuk është e pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga rrethanat apo provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

4.17. Lidhur me shpenzimet jetike⁵⁸, Komisioni saktësoi shpenzimet mujore deri në datën 23.3.2007, duke i qëndruar vlerës së vitit 2007, referuar shkresës nr. *** prot., datë 27.5.2008, të INSTAT-it, drejtuar ILDKPKI-së⁵⁹. Ndërsa për të ardhurat, Komisioni i qëndroi vlerave të tërhequra nga llogaria bankare, të cilat tregojnë fondet e disponuara efektivisht nga subjekti nga të ardhurat e përfituara përgjatë periudhës 1.1.2007 – 23.3.2007. Po kështu, vlera e shpenzimeve doganore mbeti e pandryshuar, mbështetur në dokumentacionin e administruar.

4.18. Sa më sipër, Komisioni vlerësoi të kryejë analizën financiare në datën 23.3.2007, për të ardhurat, shpenzimet, detyrimet dhe pasuritë e subjektit, personave të lidhur dhe vjehrrës së saj për shkak të jetesës së përbashkët dhe rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 590.589 lekë, në datën 23.3.2007, për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve.

⁵⁷E-mail datë 27.10.2021.

⁵⁸U përlllogaritën në vlerën 198.732 lekë nga vlera 217.590 lekë e përlllogaritur në rezultatet e hetimit.

⁵⁹Kjo shkresë gjendet në korrespondencën e ILDKPKI-së me INSTAT-in, në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, e vendosur në dispozicion të subjektit.

4.19. Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë automjet tip “Volkswagen Golf”, në kundërshtim me parashikimin e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016; si dhe (ii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 590.589 lekë, në datën 23.3.2007, për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

5. KONSTATIME TË TJERA

5.1. Nga dokumentacioni i administruar nga “Tirana Bank”⁶⁰ konstatohet se në datën 28.1.2017 (data e plotësimit të deklaratës *Vetting*), subjekti ka pasur gjendje likuiditeti në llogarinë e saj në vlerën 589.586 lekë, e cila nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting* të vitit 2017. Komisioni konstaton se kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat dhe interesat bankare.

5.2. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁶¹, subjekti i rivlerësimit shpjegon se shumat që ndodhen në këtë llogari kanë qenë me burim të vetëm nga pagat në cilësinë e gjyqtares, të cilat gjithmonë kanë kaluar nëpërmjet transaksionit bankar dhe janë deklaruar në shtojcën 2 (në deklaratën *Vetting*) në rubrikën “të ardhurat”. Për këtë pasaktësi, subjekti shpjegon se për shkak të ngarkesës dhe harresës njerëzore ka harruar ta deklarojë, pra mungon elementi i dashjes.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

5.3. Komisioni arsyeton se referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-32 dhe shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka detyrim të deklarojë në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 vlerën e likuiditeteve në llogari rrjedhëse ose në depozitë. Në kushtet kur subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 llogarinë bankare në “Tirana Bank”, Komisioni vlerëson se ka kryer deklaram të pasaktë duke vepruar në kundërshtim me germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

5.4. Në përfundim, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i likuiditeteve në llogarinë në “Tirana Bank”, në vlerën 589.586 lekë, në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

6. Analiza financiare

6.1. Komisioni kreu analizën financiare për periudhat 1994 – 2002 dhe 2003 – 2016 për të ardhurat, shpenzimet, detyrimet dhe pasuritë e subjektit dhe personave të lidhur, nga ku rezultuan disa balanca negative dhe, për këtë arsye, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimet se: (i) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vitin 2007 në shumën 674.446 lekë; (ii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vitin 2010 në shumën 1.798.672 lekë; (iii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të

⁶⁰Shkresë nr. ***, datë 14.1.2020.

⁶¹E-mail datë 23.12.2021.

ligjshme në vitin 2016 në shumën 252.031 lekë, për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën në kursime.

6.2. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁶², lidhur me analizën financiare, subjekti i rivlerësimit shpjegon se në kategorinë e të ardhurave nuk janë përfshirë të ardhurat e bashkëshortit si anëtar i KRRT-së në Bashkinë e Shkodrës në vitet 2003, 2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2011. Bashkëlidhur, ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 31.1.2017, të Bashkisë Shkodër, ku pasqyrohet listëpagesa për të ardhurat e krijuara nga i ndjeri A.D., si anëtar i KRRT-së së bashkisë, që prej vitit 1999. Lidhur me pagesën e kësteve për blerjen e apartamentit, të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit të saj në formën e fitimit *neto* janë llogaritur dhe përdorur në mars të vitit pasardhës, pra fitimi *neto* nga aktiviteti privat i vitit 2008 është llogaritur dhe përdorur në mars të vitit 2009 për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit dhe fitimi i vitit 2009 është përdorur për pagesën e këstit të dytë në mars të vitit 2010. Shpenzimet e shkollimit të fëmijëve në vitin 2010 janë llogaritur më shumë se sa kanë shpenzuar realisht, të konfirmuara edhe në dokumentacionin e marrë nga institucionet përkatëse. Konkretisht, për vitet kalendarike 2010, 2011 dhe 2012 për djalin G.D., pagesa e shkollës ka qenë në shumat: 120.000 për vitin 2010; 60.000 për vitin 2011; dhe 90.000 për vitin 2012. Pra, në total vlera 270.000 lekë, ndërkohë që nga Komisioni janë dy vlera të ndryshme për këto vite.

Po kështu, lidhur me llogaritjen e shpenzimeve për udhëtimet jashtë vendit, subjekti sqaron se: *“Komisioni nuk i është referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sepse në vendimin e referuar nga ky Komision, si dhe në asnjë vendim tjetër nuk janë llogaritur shpenzime 20 apo 25 euro për person për hyrje-dalje brenda ditës. Në rastet e daljes në Malin e Zi për pak orë, janë llogaritur për çdo person 20-25 euro, në total 80-100 euro, për pak orë qëndrimi. Për banorët e Shkodrës, Mali i Zi është shumë afër dhe nuk është respektuar harku kohor prej 15 ditësh, për llogaritjen e kartonit jeshil. Në vijim shpjegon se për udhëtimet tokësore të kryera për disa ditë 31.12.2008 - 2.1.2009, megjithëse ka shpjeguar në pyetësor që ka qëndruar në banesë private ku pagesa bëhej në bazë të shtretërve 5-6 euro/nata, Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë, por ka llogaritur për çdo person 50 euro/nata. Vlerësoj se në këtë rast Komisioni duhet të marrë në konsideratë faktin që fëmijët ishin njëri 13 vjeç dhe tjetri 4 vjeç. Bazuar në vendimin orientues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duhet të llogariteshin shpenzime qëndrimi respektivisht, 25 euro dhe 15 euro/nata. E njëjta llogaritje që duhet rishikuar është bërë në udhëtimin e datës 26.7.2009, ku djali ka qenë 14 vjeç ndërsa në udhëtimin e datës 9.2.2010, ku fëmijët kanë qenë vetëm 15 vjeç dhe 5 vjeç, kemi qëndruar në banesën e miqve tanë të vjetër, të ndjerit z. F.R. dhe znj. S.R. dhe, për këtë, ju vëmë në dispozicion deklaratën noteriale të datës 21.12.2021, të hartuar prej saj”.*

Lidhur me udhëtimet e bashkëshortit, të ndjerit A.D., të cilat i ka kryer në kuadër të projekteve të tij, për të cilat nuk duhen përlllogaritur shpenzimet e udhëtimit, por vetëm shpenzimi prej 5 euro/dita, sipas orientimit të Kolegjit dhe, konkretisht: për disa ditë 18.11.2010 - 21.11.2010, i ndjeri bashkëshorti i saj ka udhëtuar me shtetasin Xh.B., i cili ka pasur marrëdhënie bashkëpunimi lidhur me përzgjedhjen e materialeve të ndërtimit për banesën e tij, duke i mbuluar të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit, duke paraqitur deklaratën noteriale

⁶²E-mail datë 23.12.2021.

të datës 21.12.2021. Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve të mësipërme, ka paraqitur edhe dokumentacionin provues⁶³.

6.3. Më tej, në dokumentin “raport mbi procedurat e rëna dakord”, lëshuar nga audituesi ligjor H. K. (M.)⁶⁴, lidhur me kredinë në vlerën 550.000 lekë, shpjegohet se për vitin 2011 shpenzimet për kredi dhe interesa janë në shumën 201.200 lekë dhe jo në vlerën 738.050 lekë dhe, si rrjedhim, edhe gjendja e parave në fund të vitit është e ndryshme nga ajo e llogaritjeve të Komisionit.

6.4. Në përfundim, subjekti paraqiti analizën e tij financiare për periudhën 2003 – 2016, ku të gjitha vitet paraqiten me balanca pozitive, me përjashtim të vitit 2016, i cili rezulton me një balancë negative në vlerën 234.843 lekë, për të cilën ka shpjeguar: *“Vetëm në vitin 2016 rezulton me një bilanc negativ prej 234,843 lekësh, për shkak se fëmijët shpesh herë kanë marrë edhe suport modest ekonomik nga prindërit e mi, si dhe nga nëna e të ndjerit, bashkëshortit tim, duke i ndihmuar për kryerjen e shpenzimeve të jetesës së tyre, duke u munduar sado pak të zëvendësojnë mungesën e prezencës së babait të tyre”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

6.5. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

6.6. Komisioni i mori në shqyrtim pretendimet e mësipërme të subjektit dhe analizon si më poshtë:

6.7. Lidhur me të ardhurat si anëtar i *KRRR-të Shkodër të të ndjerit/bashkëshortit të subjektit*, Komisioni vëren se të ardhurat e pretenduara nga subjekti nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe as në deklaratat periodike vjetore. Megjithatë, pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe lëvizjeve të llogarisë bankare në “Tirana Bank”, ku u konfirmua kalimi në llogari i të ardhurave të pretenduara për periudhën 2007 – 2011, Komisioni vlerëson se këto të ardhura i përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, për t’u konsideruar të ardhura të ligjshme dhe i përfshiu ato në analizën financiare⁶⁵.

6.8. Për sa i përket pretendimeve të subjektit për shpenzimet e shkollimit të fëmijëve, pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur dhe shpjegimeve të dhëna, Komisioni kreu saktësimin e shpenzimeve të shkollimit në fondacionin “Gulistan”, si dhe në shkollën jopublike “Dituria”⁶⁶.

⁶³Deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.12.2021, e shtetasës S.R.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.12.2021, e shtetasit Xh.B.; ftesë e Universitetit të Studimeve në Firence dhe komunikimi elektronik me koordinatoren e projektit; vërtetim nr. *** prot., datë 31.1.2017; vërtetim nr. *** prot., datë 5.10.2021, i fondacionit “***”.

⁶⁴Paraqitur nga subjekti në seancë dëgjimore.

⁶⁵Vlerat: 112.500 lekë për periudhën përpara vitit 2003; 54.000 lekë për vitin 2003; 10.830 lekë për vitin 2007; 33.750 lekë për secilin nga vitet 2008, 2009 dhe 2010; si dhe 13.500 lekë për vitin 2011.

⁶⁶Saktësuar për vitet 2004, 2005 dhe 2006, vlera 50.000 lekë/vit dhe për vitet 2008 - 2009 vlera 65.000 lekë/vit.

6.9. *Për sa i përket shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit*, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, Komisioni vlerësoi se: (i) për sa i përket pretendimit të subjektit për shpenzimet e qëndrimit për udhëtimet brenda ditës, vë në dukje se në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit këto shpenzime janë përlllogaritur në vlerën 50 euro/dita⁶⁷ dhe, për këtë arsye, ky zë shpenzimi mbetet i pandryshuar në analizën financiare; (ii) për sa i përket pretendimit për saktësimin e shpenzimeve të kartonit jeshil, të reduktonte këto shpenzime me vlerën 15 euro për udhëtimin e datës 19.11.2005 dhe 15 euro për udhëtimin e datës 14.5.2006, ndërkohë që shpenzimet për udhëtimet e tjera mbetën të pandryshuara, pasi kartoni jeshil përlllogaritet veçmas për secilin automjet, fakt i cili nuk është marrë në konsideratë nga subjekti gjatë pretendimeve të tij; (iii) lidhur me pretendimin e subjektit për përlllogaritjen e shpenzimeve të qëndrimit të fëmijëve, sipas moshës, në momentin e udhëtimit dhe në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, u krye saktësimi për udhëtimin e datës 31.12.2008 - 2.1.2009⁶⁸ dhe për udhëtimin e datës 18.7.2008 - 26.7.2008⁶⁹. Gjithashtu, pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur për udhëtimin e datës 6.2.2010 - 20.2.2010, u përlllogaritën shpenzime qëndrimi 5 euro/person; (iv) lidhur me pretendimin e subjektit për udhëtimin e datës 18.11.2010 - 21.11.2010, pretendimet e subjektit mbetën në nivel deklarativ për sa kohë subjekti nuk provoi marrëdhënien e bashkëpunimit me shtetasin Xh.B.; (v) pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur për udhëtimin e datës 4.12.2005 - 8.12.2005, subjekti provoi marrjen përsipër të shpenzimeve nga ana e organizatorëve dhe, për këtë arsye, nuk u pasqyruan shpenzime për këtë udhëtim; (vi) lidhur me pretendimin e përlllogaritjes së vlerës 180 euro për udhëtimet në Evropë, Komisioni thekson se kjo vlerë është përdorur vetëm për fluturimet në Itali me operatorin ajror “****” dhe udhëtimet e tjera në Evropë, në përputhje me praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁷⁰.

6.10. *Lidhur me vlerën 738.050 lekë, e paraqitur si shpenzim në vitin 2011*, Komisioni thekson se në këtë vlerë përfshihet shuma e depozituar (201.200 lekë) nga i ndjeri bashkëshorti i subjektit dhe vlera e kredisë së tërhequr nga llogaria bankare (536.850 lekë), për sa kohë bëhet fjalë për kredi konsumatore dhe prezupozohet që është shpenzuar.

6.11. Për sa i përket balancës së vitit 2016, referuar sa më lart, mbetet e pandryshuar në vlerën 252.031 lekë,

6.12. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 252.031 lekë në vitin 2016 për kryerjen e shpenzimeve, duke u gjendur në kushtet e gërmës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

6.13. Në përfundim, referuar shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti në prapësime, të cilat janë analizuar në paragrafët përkatës të këtij vendimi, analiza financiare pasqyrohet në tabelën vijuese.

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditetesh bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzimet	Diferenca për shpenzime	Vitet me balancë negative
1994 - 2002	0	0	0	3,383,758	0	2,077,134	1,306,624	0
2003	0	0	0	1,108,876	0	395,456	713,420	0

⁶⁷Vendim nr. 11-2019 (JR), datë 22.5.2019, paragrafi 27.12.10.

⁶⁸U zbrit vlera 120 euro.

⁶⁹U zbrit vlera 200 euro.

⁷⁰Vendim nr. 11-2019 (JR), datë 22.5.2019, paragrafi 27.7, pika A/b.

2004	0	0	0	1,332,256	0	618,735	713,522	0
2005	0	0	406,046	1,192,879	0	643,842	142,991	0
2006	0	0	546,593	1,260,566	0	715,360	-1,387	-1,387
2007	250,000	0	-558,703	1,062,603	0	1,402,854	-31,548	-31,548
2008	0	0	-18,675	5,286,880	0	1,273,373	4,032,182	0
2009	4,680,000	0	243,964	4,014,823	2,500,000	1,273,895	316,964	0
2010	0	0	4,069	2,191,357	-2,000,000	1,258,624	-1,071,336	-1,071,336
2011	0	0	-298,519	2,318,016	550,000	1,997,530	1,169,004	0
2012	0	0	324,030	1,915,151	0	865,283	725,838	0
2013	0	0	-336,389	1,571,438	0	808,123	1,099,704	0
2014	0	0	674,075	1,942,696	0	1,084,508	184,113	0
2015	0	0	-837,127	1,596,160	0	1,387,842	1,045,444	0
2016	0	0	466,561	1,613,642	0	1,399,112	-252,031	-252,031
TOTAL	4,930,000	-	615,927	31,791,101	1,050,000	17,201,671	10,093,504	-1,356,301

Përfundimet e Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë

7. Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin në këto përfundime:

Lidhur me apartamentin e banimit me sip. 104 m², me vlerë 4.680.000 lekë, në Shkodër, subjekti i rivlerësimit:

i) Ka kryer deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë apartament, në kundërshtim me parashikimin e gurmës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

ii) Ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 1.518.666 lekë për pagimin e kështit të parë në mars të vitit 2009, duke u gjendur në kushtet e gurmës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit 84/2016.

iii) Ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 1.798.672 lekë për pagimin e kështit të dytë në mars të vitit 2010, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga germa “b”, e pikës 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me automjetin tip “Volkswagen”, të blerë në vlerën 250.000 lekë, subjekti i rivlerësimit:

i) Ka kryer deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë automjet tip “Volkswagen Golf”, në kundërshtim me parashikimin e gurmës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

ii) Ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 590.589 lekë, në datën 23.3.2007, për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve, duke u gjendur në kushtet e gurmës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

iii) Ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 252.031 lekë për kryerjen e shpenzimeve në vitin 2016, duke u gjendur në kushtet e gurmës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016

7.1. Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera,

me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 17.1.2020, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 16.1.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 14.9.2021, i kërkoi DSIK-së rishikimin e raportit mbi kontrollin e figurës së subjektit Ermira Dedja. DSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 20.9.2021, informon se pas analizës së informacioneve të ardhura nga autoritetet verifikuese gjykon se nuk është i nevojshëm rishikimi i raportit mbi kontrollin e figurës për këtë subjekt rivlerësimi.

2. Sipas raportit, subjekti i rivlerësimit Ermira Dedja: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

3. Komisioni, pavarësisht raportit të dërguar nga DSIK-ja, ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

4. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (a) ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; (b) nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (c) nuk ka bërë deklarament të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor, është organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

4. Ky vlerësim është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit bashkë me tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së.

5. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtarja Ermira Dedja ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 25.6.1990, ndërsa në datën 21.12.1993, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku vazhdon dhe aktualisht.

Aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Ermira Dedja ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile, objekt shqyrtimi gjyqësor dhe i kushton rëndësinë e duhur identifikimit të kërimit të palëve, dëgjon kërkimet procedurale të tyre, shprehet në çdo rast me urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara. Gjyqtarja Ermira Dedja ka punuar kryesisht në dhomën civile, seksioni familjar, duke manifestuar njohuri të mira në çështjet familjare që ka trajtuar, kryesisht në gjykimet me objekt zgjidhje martesë.

Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Ermira Dedja ka aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta, të kuptueshme. Qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar dhe provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit. Gjyqtarja respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor karakteret e gjuhës shqipe në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Vendimet e ndërmjetme shoqërohen me referencë ligjore (shihni pesë dosjet e vëzhguara).

Hetimi i Komisionit

6. Komisioni, pavarësisht raportit të dërguar nga KLGJ-ja, kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti, pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv dhe ankesave të paraqitura pranë Inspektoratit të KLD-së. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime dhe prova për dokumentin 2, të përzgjedhur nga subjekti dhe për dosjen nr. 3, të shortuar, si vijon:

7. Lidhur me dosjen nr. 2, vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 31.10.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti për konstatimin se: *“Janë tejkualuar afatet e gjykimit të çështjes”*.

8. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁷¹ subjekti shpjegon se çështja gjyqësore, objekt konstatimi, i përket një natyre civile që përmban në elementët e saj palë të shumta ndërgjyqëse, për të cilat duhen respektuar me rigorozitet njoftimet e tyre, me qëllim zhvillimin e një procesi të drejtë ligjor. Në thelb, shkaqet e shtyrjes së seancave janë shkaqe objektive që nuk lidhen në asnjë rast me shkaqet e saj personale, por me shkaqe procedurale në respektim të parimeve themelore të zhvillimit të një procesi efektiv gjyqësor. Nga analiza e veprimeve të gjyqtarit dhe sjelljeve të palëve, del qartazi se si shkak për mosrespektimin e afateve është bërë ndjekja e procedurës së njoftimeve me shpallje, si dhe koha e nevojshme që iu është lënë ekspertëve për kryerjen e aktekspertimit në kuadrin e një procesi të rregullt dhe të drejtë gjyqësor.

Analiza e Komisionit

9. Nga shqyrtimi i vendimit gjyqësor nr. ***, datë 31.10.2014, Komisioni konstaton se, në rastin konkret, ka të bëjë me një çështje civile me natyrë pronësie, që ka disa palë ndërgjyqëse, për të cilat duhen respektuar dispozitat procedurale të njoftimit dhe nga natyra përbën një çështje komplekse për të cilën, gjatë shqyrtimit gjyqësor, është vendosur edhe kryerja e aktekspertimit. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë shkaqe objektive, të cilat nuk varen nga gjyqtari.

10. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me tejkalimin e afateve të gjykimit të çështjes.

11. Lidhur me dosjen nr. 3, për çështjen civile nr. *** regj., datë 1.3.2016, që u përket palëve – paditësit L.B. dhe të paditurit S.B., me objekt “lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 3.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti për konstatimin se: *“Subjekti ka tejkualuar afatin e njoftimit të vendimit”*.

12. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁷², subjekti shpjegon se në seancën e zhvilluar në datën 3.3.2016, brenda afatit 48 orë nga momenti i paraqitjes së kërkesëpadisë, është depozituar shkurtimi i vendimit përkatës pranë sekretarisë gjyqësore, i cili iu është njoftuar palëve dhe subjekteve, të cilët kanë detyrimin ligjor që të ekzekutojnë vendimin brenda afatit 24 orë. Pas këtij momenti nuk është më përgjegjësi e gjyqtarit që shqyrton çështjet, njoftimi i palëve dhe subjekteve pjesëmarrëse, pasi kjo detyrë i është ngarkuar sekretarisë gjyqësore. Në mbështetje të këtij shpjegimi, gjithsesi, sqaron se njoftimi në fjalë është i konkretizuar brenda afatit, po me datë 3.3.2016. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka paraqitur kopje të shkresës nr. *** regj. themeltar, datë 3.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Analiza e Komisionit

13. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së shkresës nr. *** regj. themeltar, datë 3.3.2016, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër i ka dërguar Zyrës së Shërbimeve Sociale të Bashkisë

⁷¹E-mail datë 23.12.2021.

⁷²E-mail datë 23.12.2021.

Shkodër kopje të vendimit nr. ***, datë 3.3.2016, që i përket palëve – paditës L.B. dhe i paditur S.B., me objekt “lëshim urdhër ekzekutimi”. Kjo shkresë vërteton se subjekti e ka dorëzuar vendimin në sekretarinë gjyqësore brenda datës kur ka marrë vendimin, duke zbatuar afatin 24 orësh të parashikuar nga pika 5⁷³, e nenit 19, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

14. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me tejkalimin e afateve të njoftimit të vendimit.

DENONCIMET

15. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin Ermira Dedja janë administruar 8 denoncime nga publiku. Pas analizimit të tyre, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, nuk konstatuan problematika që kanë lidhje me kriteret e rivlerësimit të parashikuara në nenin 72 të ligjit nr. 96/2016.

Burime të tjera

16. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër⁷⁴ ka njoftuar Komisionin lidhur me çështjen gjyqësore të regjistruar pranë kësaj gjykate me palë – paditës G.Y. dhe të paditurit A.Ll., Ermira Dedja, I.K., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër; person i tretë – Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me objekt “shpërblim dëmi”. Lidhur me këtë çështje gjyqësore, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti për konstatimin se: “*Subjekti ka mbajtur dy qëndrime të ndryshme për të njëjtën çështje*”.

17. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁷⁵, subjekti shpjegoi se vendimet përkatëse mbi shqyrtimin e kërkesës për përjashtim të gjyqtarës A. Ll., nuk përmbajnë lidhje substanciale me njëra-tjetrën, pasi rrethanat për secilën prej këtyre dy rasteve janë të ndryshme në përmbajtjen e tyre. Përkatësisht, në vendimin nr. ***, ku është pranuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës, arsyeja e vetme lidhej me shfaqjen në dukje të një mendimi paragjykues ndaj procesit, duke përdorur shprehjen: “*Ty të është ekzekutuar detyrimi që ka pasur pala e paditur pasi t’i kanë kaluar lekët në bankë dhe nuk e di se çfarë kërkon*”. Nga ana tjetër, kjo rrethanë e ndodhur në këtë proces gjyqësor, nuk është përsëritur në procesin tjetër civil të iniciuar prej kësaj pale dhe, në këto kushte, nuk mund të thuhet se ndodhet përpara të njëjtave rrethana, të cilat ndikojnë në vendimmarrjen eventuale të trupës që e gjykon. Në vijim, subjekti shpjegon se për identifikimin e së njëjtës çështje dhe të kuptohet natyra e mosmarrëveshjes, janë të nevojshëm këta elementë: (i) palët aktive, si subjekte kërkuese; (ii) palë pasive, si subjektet ndaj të cilëve drejtohet kërkimi; (iii) shkaku i kërkimit (*causa petendi*), qoftë në (a) kuptimin e fakteve konstitutive mbi të cilët bazohet kërkimi; qoftë në praninë e (b) shkakat ligjor, ku bazohet kërkimi dhe cilësimi ligjor i tij; (4) kërkimi (*petitum*), pra objekti se çfarë kërkohet me anë të kërkesës.

⁷³Ligji nr. 9669/2006, neni 19: “‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’, në të cilin parashikohet: ‘[...]5. gjykata brenda 24 orëve pas lëshimit të vendimit, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim: (a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim ...[...].’”.

⁷⁴Shkresë nr. *** regj. them., datë 5.5.2019.

⁷⁵E-mail datë 23.12.2021.

Vetëm nëse do të ndodhet përballë përkimit (përputhjes) të këtyre elementëve të njëjtë në dy çështje do të mund të flitet për një vendimmarrje të njëjtë.

Analiza e Komisionit

18. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër dhe nga verifikimi i faqes elektronike gjykata.gov.al rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, kryesuar nga gjyqtare Ermira Dedja, në datën 29.9.2017, ka marrë në shqyrtim çështjen civile nr. *** Akti, që u përket palëve – kërkuar G.Y., person i tretë – Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., me objekt “përjashtimin e gjyqtarës A.Ll. nga gjykimi i çështjes civile” me palë - paditës G.Y., i paditur shoqëria “OST”; me objekt: (i) konstatimin e ekzistencës së vonesës në mosekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimi civil datë 31.5.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; (ii) përcaktimin e kohëzgjatjes së vonesës për secilën nga detyrimet me të cilat vendimi civil i ngarkon palët e paditura; (iii) detyrimi i palëve të paditura për shpërblimin e dëmit të ardhur nga vonesa dhe detyrimin e ndërëgjyqësve për pagimin e shpenzimeve gjyqësore.

19. Kërkuar ka pretenduar se gjyqtarja A. Ll. gjatë zhvillimit të seancës përgatitore në datën 12.9.2017, e ka pyetur se me çfarë e provonte që nuk e kanë ekzekutuar detyrimin. Sipas çmuarjes së tij, kjo vinte në kundërshtim me nenin 12 të Kodit të Procedurës Civile, pasi barra e provës i takonte palës së paditur dhe se gjatë zhvillimit të seancës, gjyqtarja është treguar e njëanshme. Konkretisht kur ai i është përgjigjur pyetjes së gjykatës se sa ishte shpërblimi që kërkonte nga pala e paditur në rast të zgjidhjes së çështjes me pajtim, ka thënë *se e di gjykata se sa është masa e dëmshpërblimit, por fundja edhe 10 lekë të vjetra, por pala e paditur duhet të paguajë edhe shpenzimet gjyqësore për avokat që kam bërë*. Gjyqtarja reagoi me fjalët: “*Mos m'i bëj këto lojëra*”, “*Mos m'i bëj këto në sallën time*”. Gjithashtu, ka pretenduar se gjyqtarja e ka shprehur qëndrimin e saj të anshëm edhe në momentin kur i është drejtuar me shprehjet se: “*Ty të është ekzekutuar detyrimi që ka pasur pala e paditur pasi t'i kanë kaluar lekët në bankë dhe nuk e di se çfarë kërkon*”. Me vendimin nr. ***, datë 29.9.2017, gjykata, e kryesuar nga gjyqtare Ermira Dedja, vendosi pranimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarës A. Ll. nga gjykimi i çështjes civile me nr. *** regj. themeltar, datë 12.6.2017, me arsyetimin se ekzistojnë shkaqe që mund të cenojnë dukjen e paanësisë së trupit gjykues.

20. Gjithashtu, rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër po gjykohej çështja civile nr. ***, me palë – paditës G.Y.; e paditur shoqëria “OST”, me objekt “detyrimi i të paditurit për pagimin e pagës së prapambetur deri në momentin kur paditësit t'i sigurohet mbrojtja nga diskriminimi”. Sipas shortimit elektronik këto çështje i kanë kaluar për gjykim gjyqtarës A. Ll. Me kërkesën drejtuar gjykatës në datën 14.9.2017, denoncuesi ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarës A. Ll. nga gjykimi i çështjes civile me nr. ***, me datë dorëzimi 11.9.2017, duke parashtruar përpara gjykatës të njëjtat pretendime të pasqyruara në vendimin nr. ***, datë 29.9.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Dhe, në këtë rast, kërkesa është gjykuar nga gjyqtarja Ermira Dedja, e cila në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. ***, datë 29.9.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Në arsyetimin e vendimit, Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër është shprehur se: “[..] nuk rezultoi që gjyqtarja të ketë dhënë këshilla, të ketë shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo të ketë shfaqur arsye serioze njëanshmërie, kërkesa thelbësore këto të parashikuara në nenin 72/4/6, të Kodit të Procedurës

*Civile [...]. Për sa i përket qëndrimit të saj, i cili në dukje cenon paanësinë e gjyqtarit, kjo gjykatë është shprehur me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 29.9.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Për sa i përket pretendimit tjetër, i cili lidhet me parimin se për çështje të njëjta vlejné zgjidhje të njëjta, nga kërkuesi nuk u paraqit asnjë provë, kriter ligjor, që detyrojnë kërkuesin të provojë pretendimin e ngritur, ndaj edhe kjo pjesë e kërimit mbetet e paprovuar”.*

21. Referuar fakteve të mësipërme, Komisioni arsyeton se nenit 72⁷⁶ i Kodit të Procedurës Civile përcakton se gjyqtari është detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete, kur ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim, si dhe kur vërtetohen sipas rrethanave konkrete arsye serioze njëanshmërie. Gjykata Kushtetuese⁷⁷, në jurisprudencën e saj, është shprehur se: “[...] Gjykata thekson se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vetë subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimin nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim.[...]. Karakteri thelbësor i rasteve të papajtueshmërisë i referohet në fakt hipotezës specifike në të cilën vlerësimi paragjykes, megjithëse është shprehur në një proces formalisht të ndryshëm nga aktuali, i përket një ngjarjeje thelbësisht të njëjtë për procesin, që mund, ose duhej të ishte gjykuar në kontekstin e vetë procesit. Paragjykimi eventual për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt”.

22. Lidhur me shpjegimin e subjektit se nuk ndodhej përpara të njëjtit fakt, pasi çështjet kanë objekt dhe shkaqe të ndryshme, Komisioni arsyeton se referuar teorisë së të drejtës civile, faktet juridike janë veprimet e njeriut ose ngjarjet natyrore që shkaktojnë lindjen, ndryshimin apo shuarjen e marrëdhënieve juridike. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin njëhësues nr. 3, datë 29.3.2012, ndërmjet të tjerave, arsyetojnë se një fakt i caktuar mund të sjellë lindjen e shumë marrëdhënieve juridike të njëkohshme apo të njëpasnjëshme. Marrëdhëniet juridike në fjalë qëndrojnë në themel të shkakut të padive respektive që mund të ngrihen nga subjektet pjesëmarrëse të këtyre marrëdhënieve juridike. Lidhur me “objekt i mosmarrëveshjes” dhe “objekt i padisë”, të përdorura në nenet 5 dhe 185 (1) të Kodit të Procedurës Civile, arsyetojnë se i referohen të njëjtës gjë. Ato janë tërësia e pretendimeve të bëra nga paditësi në padi, për të cilat gjykata duhet të shprehet me vendim, neni 31 (1) i Kodit të Procedurës Civile. Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes, që i paraqitet gjykatës për zgjidhje, është në disponibilitetin ekskluziv të palëve dhe gjykata nuk mund të ndërhyjë në formulimin e tij. Ndërsa lidhur me “shkakun e padisë”, arsyetojnë se shkakun e padisë është kombinimi i faktit cenes dhe i së drejtës subjektive mbi të cilën bazohet padia e që ka lidhje me marrëdhënien juridike që është themeli i pretendimit të paraqitur me kërkesëpadi në gjykatë. Shkakun e padisë përbëhet nga dy elementë: (i) e drejta subjektive, e cila gjen burimin e saj tek e drejta objektive; dhe (ii) gjendja e faktit kundër kësaj të drejte.

⁷⁶Kodi i Procedurës Civile, neni 72: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: [...] .4. Ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim [...] .6. Në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”.

⁷⁷Vendimi nr. 1, datë 25.1.2010.

23. Komisioni vlerëson se pavarësisht se objekti i padisë dhe shkak ligjor në procesin gjyqësor që pasqyrohet në vendimin nr. ***, datë 29.9.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është i ndryshëm nga objekti i padisë dhe shkak ligjor i pasqyruar në vendimin nr. ***, datë 29.9.2017, të po kësaj gjykate, në thelb ato lidhen me mosmarrëveshjen e marrëdhënieve të punës ndërmjet të njëjtave palë, paditësit G.Y. dhe të paditurit shoqëria “OST”. Si pasojë, Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër ndodhej përpara të njëjtit fakt me të njëjtat subjekte (palë), por me objekt dhe shkak të ndryshëm.

24. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi profesionale, për sa i përket aspektit të njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë, si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, kriter i parashikuar nga pika 2⁷⁸, e nenit 72, të ligjit nr. 96/2016.

Përfundimet e Komisionit në lidhje me rivlerësimin e aftësive profesionale

Pavarësisht sa më sipër, në raport me të gjitha çështjet e analizuar, rezulton se subjekti shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit dhe në kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, si dhe zotëron njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor, referuar nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në përfundim, Komisioni, në vlerësimin tërësor të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ermira Dedja është “e aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është efiçente në masë të pranueshme.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, vendosi që subjektit të rivlerësimit Ermira Dedja, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ermira Dedja, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁷⁸Ligji nr. 96/2016, neni 72: “1. Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të gjyqtarit vlerësohet aftësia profesionale e gjyqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor. 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë, si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën ...[...].”

2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 12.1.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj